



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.11.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Enver Roshi - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Seancën dëgjimore për çështjet e sociale

Marrin pjesë:

Enver Roshi, Klodiana Spahiu, Arben Kamami, Ilir Pendavinji, Edlira Bode, Adelina Rista, Klotilda Bushka, , Florenc Spaho, Majlinda Halilaj, Eugen Bojaxhiu, Koçi Tahiri, Amra Barova, Ervis Meço, Edmond Stojku, Vilma Bello, Blerina Gjylameti, Aurora Mara dhe Ediola Braha

Mungojnë: Roland Xhelilaj, Almira Xhembulla, Ardiana Jaku

Të ftuar:

Blerina Xhani – përfaqësuese nga UN Women

Erisa Cela - përfaqësuese nga UN Women

Ervis Cota – Drejtor i Lëvizjes Rinore Egjiptiane dhe Rome

Fationa Kaca – përfaqësuese nga Lëvizja Rinore Egjiptiane Rome

Alketa Zazo – përfaqësuese nga UNICEF-i

Mariana Bukli - përfaqësuese nga UNICEF-i

Hiqmet Melasi – përfaqësues nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura Shqiptare

Koco Jani – përfaqësues nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura Shqiptare

Irena Shtraza – përfaqësuese nga AWEN “Rrjeti i fuqizimit të Gruas”

Merita Xhafaj – Drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Lulëzim Resuli – përfaqësues i Shoqatës së Jetimeve të Shqipërisë

Endrit Reka - përfaqësues i Shoqatës së Jetimeve të Shqipërisë

Sinan Tafaj – përfaqësues i Bashkimit të Organizatave të Personave me Aftësi të kufizuar

Arged Tafaj - Bashkimi i Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar

Halil Cakani - Bashkimi i Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar

Kol Nikollaj - përfaqësues i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë

Arben Malaj – përfaqësues i Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë

Anisa Subashi - përfaqësuese e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë

Aderian Hysa - Përfaqësuesit e të verbërve të Shqipërisë

Armand Nexha - Përfaqësuesit e të verbërve të Shqipërisë

Abdulla Omuri - përfaqësues i Shoqatës së Invalidëve të Punës

Mark Zefi – përfaqësues i Shoqatës së Invalidëve të Punës

Një grup prindërisht për fëmijët me aftësi ndryshe të përfaqësuar nga Lirie Dina dhe Elenica Kotelli

Anila Nepravishta – përfaqësuese e Avokatit i Popullit

Brikena Qirjazi – përfaqësuese nga Fakulteti i Mjekësisë

Ndrek Ismaili – përfaqësues i Shoqatës së Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikeve

HAPET MBLEDHJA

Enver Roshi – Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë për miratimin e buxhetit të vitit 2020.

Sot meqenëse është java e antibiotikëve, pra rezistenca mikrobike e antibiotikëve, Komisioni i Shëndetësisë është i veshur me bluza të bardha dhe me logon “Antibiotikët nuk janë karamеле”. Me këtë rast dëshiroj të përshëndes organizuesit, OBSH-në, Departamentin e Farmacisë në Fakultetin e Mjekësisë, Urdhrin e Farmacisë, Qendrën Kombëtare të Barnave, Institutin e Shëndetit Publik dhe të gjithë profesionistët e shëndetësisë që ndërgjegjësojnë qytetarët, dhe të profesionistëve për përdorimin sa më pak të antibiotikëve. Rezistenca antimikrobike e antibiotikëve konsiderohet si një ndër sfidat madhore të shëndetit publik në Europë dhe në Shqipëri.

Kaq sa për hapje.

Sot sipas agjendës kemi seancë dëgjimore për çështjet sociale.

Marrin pjesë: nga UN Women, Blerina Xhani dhe Erisa Çela, nga Lëvizja egjiptianë dhe rome, Ervis Çota dhe Fatjona Kaca, nga UNICEF-i Alketa Zazo dhe Marjana Bukli, Iva Zaimi, nga Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, Hyqmet Melasi dhe Koço Jani, nga Rrjeti i Fuiqzimit të Grave Ejona Shtraza, nga Ministria e Shëndetësisë Merita Xhafaj, drejtoreshë e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale, nga Shoqata e Jetimëve të Shqipërisë, Lulzim Resuli dhe Endri Reka, nga Bashkimi i Organizatave të Personave me Aftësi të Kufizuar Sinan Tafaji, Argent Tafaja dhe Halil Cakani, nga përfaqësuesit e të verbërve të Shqipërisë Adrian Hysa dhe Arman Nexha, është gjithashtu i ftuar një grup prindërisht të fëmijëve me aftësi ndryshme të përfaqësuar nga Liri Dina dhe Linza Koteli, nga Avokati i Popullit Anila Nepravishta, nga fakulteti i Mjekësisë Brikena Qirjazi, kemi të ftuar edhe nga Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë Kol Nikollaj, Arben Malaj dhe Anisa Subashi, të cilët ishin edhe dje këtu, nga Shoqata e Meritave të Punës Abdullah Omuri dhe Mark Zefi, si dhe nga Shoqata e Paraplegjikëve dhe Tetraplegjikëve, Ndrec Ismaili.

Do ta filloj duke ua kaluar fjalën zonjave Blerina Xhani dhe Erisa Çela.

Ju lutem, të përqendrohemi të kërkesat tuaja për buxhetin! Përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë do t’u përgjigjen kërkesave tuaja për arritjen e qëllimeve tuaja.

Ju lutem, para se të filloni, prezantoni veten dhe shoqatën tuaj për efekt të regjistrimit të audios.

Erisa Çela – Përshëndetje!

Unë quhem Erisa Çela dhe bashkë me kolegen time Blerina Xhani jemi përfaqësuese të Agjencisë së Kombeve të Bashkuara për Barazinë Gjinore. Prej disa vitesh punojmë me Ministrinë e Shëndetësisë, me Ministrinë e Financave dhe institucione të tjera për promovimin e buxhetimit gjinor në Shqipëri, pra adresimin e pabarazive gjinore përmes buxheteve.

Ne ju falënderojmë për mundësinë për të dhënë disa komente lidhur me projektbuxhetin e vitit 2020!

Për të dhënë pak kontest, UN Women, në bashkëpunim me të dyja ministritë që përmenda kanë që në krye të vitit që punojnë për të përfshirë pabarazitë gjinore në projektbuxhetin e vitit 2020, pra le të themi që ky draft që ne shohim sot nuk është një surprizë, por një dokument për të cilin kemi punuar. Sigurisht që komentet tona i kemi parashtruar edhe me shkrim ndaj nuk do të ndalem në teknikalitet, por do të doja të bëja vetëm dy komente kryesore:

E para, do të doja t'u bëja thirrje të gjitha institucioneve që punojnë për PBA-të, veçanërisht për buxhetin e vitit 2020, që ka një detyrim ligjor sipas ligjit organik të buxhetit, i cili parashtron se të paktën një program buxhetor dhe objektiv duhet të ketë të paktën një indikator performance, që adreson çështjet e barazisë gjinore. Ndaj të gjitha institucioneve u lind detyrimi që në përgatitjen e buxheteve të tyre, përfshi edhe institucionet që propozojnë buxhetin në këtë komision, duhet të adresojnë pabarazitë gjinore në buxhetet e tyre dhe kjo duhet të jetë në përputhje me strategjinë e barazisë gjinore dhe ligjin. Ndërkohë ne kemi bërë edhe një analizë të projektbuxhetit të vitit 2020, duke parë se cilat janë hendeqet kryesore. Unë jam e sigurt se shoqëria civile këtu do të ketë komentet e saj. Kryesisht vëmë re që në përgjithësi ka rritje të buxhetit për barazinë gjinore krahasuar me vjet, ka rritje buxhetore në programet buxhetore, në ministritë e linjës, që adresojnë pabarazitë gjinore, si dhe në buxhetin total.

Nga një analizë paraprake, që kemi kryer në këtë PBA, vëmë re që buxheti, që u përgjigjet pabarazive gjinore, është rritur në 7,2%, por ne sugjerojmë që duhet të fillojmë të punojmë për të parë se sa realisht kjo përqindje adreson çështjet e pabarazive gjinore dhe vëmë re që ka hendeqe në programet buxhetore të Ministrisë së Bujqësisë, e cila ka punuar gjithmonë për të adresuar çështjet e buxhetimit gjinor, por duke pasur parasysh skemat e IPARD-it dhe të subvencionimit, vihet re që ka nevojë për një rritje të masave specifike që do të ndihmonin gratë dhe vajzat fermere në mënyrë që edhe ato të kenë akses në skemat e subvencionimit, duke pasur parasysh edhe pengesat që ato kanë në lidhje me aksesin në tokë, regjistrimin e fermave e kështu me radhë.

Vëmë re që ka nevojë për rritjen në programet buxhetore, që duhet të adresohen nga Ministria e Mjedisit dhe Turizmit, si dhe për një përputhje më të mirë të programit të 100 fshatrave, për sa i përket punësimit të grave në bizneset e artizanatit.

Unë mund të vazhdoja pa fund, pasi ne kemi informacion për të gjitha ministrinë, komentet tona i kemi dorëzuar me shkrim për këto pabarazi, por do të preferoja të dëgjoja më shumë edhe nga shoqëria civile lidhur me buxhetet dhe barazinë gjinore. Vura re që ka organizata që punojnë në fuqizimin e grave për të adresuar këtë buxhet.

Enver Roshi – Ju lutem, na thoni konkretisht që ky indikator është kaq lekë dhe duam kaq lekë, se kështu humbasim në filozofi. Nevojat janë aq të mëdha sa që do të duhet disa buxhete që të përmbushin kërkesat. Parimet t’i lëmë për herës tjetër!

Erisa Çela – Dakord, ne i kemi dorëzuar komentet tona me shkrim dhe nëse unë filloj të lexoj se sa përqind kërkojmë për çdo buxhet mendoj se do të humbisja kohën e të gjithëve. Në parim po them që hendeqet kryesore që shohim janë në fushën e bujqësisë, të zhvillimit rural, të mjedisit dhe turizmit e sidomos të infrastrukturës.

Enver Roshi – Janë tema që duhet të parashtrihen edhe në ministrinë e linjës. Ju vetë keni një shoqatë shumë dinjitoze, por është mirë të bëni një prioritetizim, pasi kjo është nga më të rëndësishmet, sepse janë gjithë këta që kanë kërkesa, ju e dini vetë punën tuaj, unë nuk ndërhyj.

Erisa Çela – Ne kemi punuar dhe u kemi dhënë asistencë të gjitha ministrive të linjës në nivel qendror. Këto janë rekomandime që ne ua kemi dhënë edhe ministrive edhe Ministrisë së Financave dhe kemi gjetur bashkëpunimin e Ministrisë së Financave për t’i integruar.

Në radhë të parë, ne e njohim kontributin e ministrive për t’i marrë në konsideratë këto nevoja dhe thjesht japim disa rekomandime për të përmirësuar situatën. Komentet e tjera janë me shkrim.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit!

Fjalën po ia kaloj zonjës Merita nga Ministria e Shëndetësisë.

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë besoj dhe e kuptoj nga ajo që u trajtua nga përfaqësuesja e Agjencisë UN Women, se ka nevojë për një prononcim të Komisionin e Shëndetësisë lidhur me projektbuxhetet e të gjitha ministrive të tjera, që do të thotë se nëse ne kemi në fokusin dhe në përgjegjësitë e kësaj ministrie edhe çështjet e barazisë gjinore, kërkojmë edhe mbështetjen e Komisionit të Shëndetësisë për të adresuar pjesën e buxhetimit gjinor edhe në komisionet e tjera parlamentare ku diskutohet projektbuxheti. Konkretisht, në Komisionin e Sigurisë, sepse

pozicioni i gruas, grua ja paqja dhe siguria janë kyç për momentin, në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, në Komisionin e Mjedisit, pra në të gjitha komisionet parlamentare, por edhe në Komisionin e Ekonomisë të kërkohet nga ana e Komisionit të Shëndetësisë që të vendosen indikatorë dhe produkte për politikën e barazisë gjinore. Çështjet e dhunës ndaj grave u takojnë të gjithë sektorëve, çështjet e marrëdhënieve të punës dhe diskriminimit apo të *gap-it*, që ekziston në pagesat mes burrave dhe grave prapë janë politika, të cilat ndiqen nga punëdhënësit dhe punëmarrësit. Unë besoj se është angazhimi ynë, por kemi nevojë edhe për mbështetjen e komisionit për të dhënë një koment dhe kërkesë për të gjitha komisionet e tjera.

Faleminderit!

Edlira Bode – Faleminderit zonjës dhe drejtoreshës nga ministria! Në fakt, është një nënkomision i këtij komisioni, Nënkomisioni i Barazisë Gjinore. Unë mendoj që gjithë kjo mund të bëhet në një dëgjuesë të veçantë me praninë tuaj në këtë nënkomision pastaj nëpërmjet tij mund të bëhet një program bashkëpunimi me nënkomisionet e tjera. Meqë e kemi këtë nënkomision me detyrë specifike barazinë gjinore dhe ndjeshmërinë gjinorë, atëherë mendoj se mund të vazhdojmë në këtë drejtim, pra të organizojmë një tjetër seancë dëgjimore të Nënkomisionit për Barazinë Gjinore.

Faleminderit!

Ilirjan Pendavinji – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, unë po dëgjoja me vëmendje fjalën e zonjës dhe po shihja edhe relacionet që kanë sjellë. Ka disa projekte që qeveria shqiptare i ka mbështetur në vite dhe po i mbështet edhe sivjet, madje janë incentivuar goxha projekte për pjesën e mbështetjes së grave, sidomos për IPARD-in. Pikëzimi është një nga ato vlera që e diskriminon pozitivisht rolin e gruas dhe me sa di unë një pjesë e mirë janë mbështetur. Ju jeni specifikisht për pjesën e lëvizjes së buxhetit dedikuar me përqindje. Mbase ne do të bëjmë një relacion për Komisionin e Ekonomisë dhe disa sugjerime pasi të mbarojmë këto seanca dëgjimore, por besoj se ky buxhet është një nga mbështetësit më të mirë të kësaj pabarazie dhe e diskriminon pozitivisht rolin e gruas në shoqërinë shqiptare, si në Ministrinë e Kulturës dhe Turizmit, në Ministrinë e Bujqësisë dhe në Ministrinë e Rinisë dhe Sportit. Gjithsesi do t'i relatojmë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Po, zoti Kamani.

Arben Kamani – Kam vetëm një ndërhyrje të shkurtër.

Dëgjoja zonjën që foli paraprakisht për problemin e mbështetjes së grave me fondet e IPARD-it. Ekziston një problem shumë serioz se kjo mbështetje, sepse mbi 99% e pronave dhe e bizneseve bujqësore janë me emrin e kryefamiljarit dhe është tmerrësisht e vështirë të

ndërhyhet për diskriminim pozitiv për gratë. Duhet bërë të paktën fillimisht ngritja e biznesit bujqësor me emrat e grave. Unë mbuloj një zonë bujqësore dhe pothuajse të gjitha bizneset bujqësore, që janë rimbursuar, janë me emrat e kryefamiljarëve burra.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, doktor Beni!

Unë mendoj se edhe Nënkomisioni i Barazisë Gjimore është më i gjerë, pasi përfshin të gjitha gratë e parlamentit, por edhe deputetë dhe një pjesë e rëndësishme e çështjeve që ngritët prapëseprapë duhet të adresohen atje. Kjo nuk e eliminon mundësinë që ju t'i parashtroni edhe këtu, sigurisht edhe atje me qëllim që të përhapet në të gjitha komisionet parlamentare.

Ervis Çolla - Përshëndetje!

Unë jam Ervis Çolla, drejtues ekzekutiv i Organizatës Lëvizja Rinore Egjiptiane dhe Rome.

Kërkesa ime ka të bëjë me rritjen e buxhetit sa i takon mbështetjes së familjeve të varfra që trajtohen me ndihmë ekonomike për t'u kompensuar me sasinë e duhur për furnizimin me energji elektrike. Sipas të dhënave zyrtare të marra nga institucionet shqiptare, ndër to edhe nga Ministria e Shëndetësisë, rezulton se trajtohen me ndihmë ekonomike rreth 60 mijë familje shqiptare, ndër to vetën 22 mijë e marrin kompensimin e energjisë elektrike, pra rreth 37%, kurse pjesa tjetër nuk e merr.

Masa në të cilën këto familje marrin kompensimin e energjisë elektrike në muaj bashkë me ndihmën ekonomike, është 120 lekë në muaj ose e përkthyer në 130 kilovat/orë në muaj. Kompensimi aktual që u bëhet familjeve rezulton të jetë i pamjaftueshëm në raport me nivelin apo me nevojën për furnizimin bazë me energji elektrike. Sasia bazike, jetike që duhet të ketë çdo familje që trajtohet me ndihmë ekonomike, pra çdo familje e varfër në shtetin shqiptar është 200 kilovat/orë në muaj ose rreth 1900 lekë në muaj, pra rreth 700 lekë të reja më shumë se kompensimi aktual. Kjo është e diktuar edhe nga komuniteti i energjisë elektrike, ku bën pjesë edhe Shqipëria, e cila tregon se një familje e varfër me 4 anëtarë, konsumin total bazik mujor për energjinë elektrike e ka 200 kilovatorë në muaj. Një gjë e tillë na ka rezultuar edhe nga një llogaritje e konsumit minimal të energjisë elektrike, që e kemi bërë përmes një aparati matës digjital multifunksional të një shkalle të lartë të cilësisë. Ka rezultuar se sasia minimale është 210 kilovatorë në muaj, duke marrë në konsideratë pajisjet elektrike të domosdoshme për jetesën e këtyre familjeve të varfra. Gjithashtu, matjet kanë marrë në konsideratë edhe studimin e ERE-s, Entit Rregullator të Energjisë Elektrike. Kjo shifër, për ta rrumbullakosur, po themi, 200 kilovatorë në muaj, është krahasuar edhe me të dhënat e konsumit mesatar, që rezultoi nga aktmarrëveshjet e lidhura me familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike.

Duke bërë një analizë të këtyre të dhënave të marra nga OSHEE-ja, rezulton se konsumi mestar i energjisë elektrike i kësaj kategorie abonentësh familjarë për vitin 2017 është 2437 kilovatorë në vit ose mesatarisht 203 kilovatorë në muaj. Këto familje, që aktualisht e marrin kompensimin e energjisë elektrike, pra ky 37- përqindëshi, do të duhet të plotësojnë edhe 15% nga të ardhurat e tyre, që është ndihma ekonomike, për të mbuluar nevojën minimale prej 200 kilovatorësh në muaj, ndërsa 62% e familjeve të tjera, që nuk e marrin kompensimin e energjisë elektrike, duhet të shpenzojnë nga të ardhurat e tyre rreth 40%. Imagjinoni që një familje me katër anëtarë merr një ndihmë ekonomike prej 5000 lekësh të rinj dhe 40% të këtyre të ardhura duhet t'i çojë përr shlyerjen e energjisë elektrike!

Kështu që, për të mos u zgajtur, rekomandimi im ka të bëjë me rritjen e masës së kompensimit të energjisë elektrike për një familje, me vlerën 700 lekë në muaj, e cila kërkon një rritje të buxhetit për vitin 2020 në sektorin e mbështetjes sociale, konkretisht, produkti i ndihmës ekonomike me 44 milionë lekë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Fjala për ju, zonja Merita.

Merita Xhafaj– Aktualisht, sikurse e tha edhe përfaqësuesi i Lëvizjes Rome dhe Egjiptiane, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në projektbuxhetin e saj për vitin 2020 ka vendosur masën e kompensimit të energjisë elektrike, bazuar në dy vendimet e Këshillit të Ministrave. Nëse përfitojnë 22 familje apo 66 mijë familje, kjo është rezultat i aplikimit apo i mosaplikimit nga familjet që përfitojnë.

Në fakt, në projektbuxhet është përfshirë gjithë shuma për të gjitha familjet që janë përfituese të skemës së ndihmës ekonomike.

Natyrisht, ne kemi përgjegjësinë të informojmë administratorët, të cilët duhet të informojnë më mbrapa ata që aplikojnë për ndihmë ekonomike, për bonusin që marrin për efekt të vazhdimit të shkollës së fëmijëve apo vaksinimit, sikurse edhe për kompensimin e energjisë elektrike.

Analiza dhe studimi i bërë për masën e plotësimit të kompensimit të energjisë elektrike, është e lidhur me pagesën në total të faturës së energjisë elektrike, që të gjitha familjet nuk e kanë të njëjtë. Nuk mund të themi dot se të gjitha familjet, që përfitojnë nga skema e ndihmës ekonomike, konsumojnë të njëjtën sasi energjie elektrike, sepse kjo nuk është e vërtetë.

Ne kemi ngritur një grup pune, së bashku me Entin Rregullator të Energjisë, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Ministrinë e Financave, që të shikojmë mënyrën se si do ta mbulojmë këtë.

Besoj se problemi në këtë moment është se si do të konsiderohen ata që janë debitorë, për shkak se nuk kanë ditur të aplikojnë për të marrë kompensimin. Më shumë është ky problemi sesa problemi tjetër për 700 lekë, që është diferenca (flitet me lekë të rinj) nga përllogaritjet e tyre.

Ne kemi ngritur një grup pune dhe jemi duke e parë në detaj këtë problem, sepse edhe ne jemi të angazhuar për mbrojtjen e të drejtave të të gjitha shtresave vulnerabël. Natyrisht, kjo është një nga problematike, që shumë shpejt do të marrë zgjidhje.

Faleminderit!

Enver Roshi – Po...

Ervis Çota - Faleminderit për përgjigjen tuaj, zonja Xhafa, por unë e konsideroj shumë jetike këtë gjë! Ajo për të cilën ju thoni se nuk është e vërtetë, që këto familje e kanë mesatarisht të nevojshme 200 kilovatorë, është plotësisht e vërtetë, sepse këtë e thotë edhe Komuniteti i Energjisë Elektrike dhe e ka specifikuar mjaft qartë. Ky është problem shumë madhor, sepse në rast se një familje, vetëm me kompensimin prej 12 mijë lekësh që merr, nuk arrin dot të plotësojë faturën korente të energjisë elektrike, atëherë i ndërpritet energjia elektrike dhe në rast se ndodh që kjo familje do të bëjë ndonjë lidhje të paligjshme, mund të ndiqet edhe penalisht. Ne kemi raste të shumta në shtetin shqiptar, ku familje të tilla janë përballur me prokurorinë shqiptare. Kështu që rritja e këtij niveli është jetike dhe shumë e domosdoshme.

Pa diskutim, edhe pjesa tjetër, që nuk e merr... Edhe këtu ka nevojë për një informim, por duhen parë edhe kriteret, sepse ju e dini shumë mirë që ka edhe disa kriteret që e penalizojnë familjen: dorëzimi paraprakisht i faturës së energjisë elektrike tek administratori i lagjes, ndërkohë që ai nuk ka me çfarë ta paguajë kur nuk e merr në dorë këtë kompensim dhe më pas të paguajë faturën e energjisë elektrike. Megjithatë, kjo është një çështje tjetër dhe mund ta diskutojmë edhe veçmas, por rritja e sasisë është shumë e domosdoshme.

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Ka një problem lidhur me këtë dhe duhet ta kuptojmë të gjithë. Ata që aplikojnë për të marrë ndihmë ekonomike, në skemën e ndihmës ekonomike, nuk kanë prona dhe është pikërisht ky problemi, sepse duke mos pasur prona, pjesa e faturës së energjisë elektrike nuk lëshohet në emër të tyre, por në emër të pronarit të shtëpisë ku ata banojnë apo nuk lëshohet fare faturë. Pra, ky është një problem, që është duke u trajtuar nga grupi i punës. Ju them se shumë shpejt do të zgjidhet, sepse ky problem është duke u diskutuar edhe me grupe të tjera interes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, i shkon shtëpisë.

E rëndësishme është ta ndajmë, nëse kjo do të kalojë si puna e vendimit të ujit, subvencion për OSHEE-në, dhe të mbyllen të gjitha kontrata apo kjo... Ky është çelësi i problemit që duam të zgjidhim sot. Vetëm në këtë mënyrë zgjidhet ky problem.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se brenda tremujorit të parë të vitit që vjen do të zgjidhet.

Arben Kamami – Faleminderit!

Pa dashur të bëj debat me zotërinë, e kuptoj shumë mirë që kompensimi nuk është maksimal, por edhe në vende europiane mjaft të zhvilluara në të tilla raste kompensimi është vetëm për ndriçimin dhe frigoriferin.

Faleminderit!

Edlira Bode – Ndjesë!

Shumë faleminderit, zonja Xhafaj!

E kuptojmë që ka një problem, por kuptojmë fare mirë edhe që ju po merreni, po mundoheni ta zgjidhni këtë problem dhe do të kemi shumë shpejt një zgjidhje. Unë po ndërhyj, sepse në fjalën e zotërisë më kapi veshi shifrën e ndihmës ekonomike që merr një familje që aplikon për ndihëm ekonomike. Ne kemi miratuar një ligj për ndihmën ekonomike dhe herë pas here kemi bërë shumë ndryshime tek ai ligj. Uroj të mos jem gabim, por një familje që merr ndihmë ekonomike e ka vlerën e ndihmës 8 mijë lekë në muaj, apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E kam gabim? Sa është vlera? Sepse zotëria na foli për shumë më pak.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Faleminderit!

Sikurse keni miratuar ligjin, ju e dini që ka një afat 6-mujor për të bërë paketën e akteve nënligjore. Për shkak se është hequr, me propozimin tuaj, pra të deputetëve, pjesa e tavanit të ndihmës ekonomike, është një nga aktet nënligjore që do të miratohet shumë shpejt.

(Mungesë regjistrimi)

Koço Jani – Përsëritje të gjithëve!

Unë përfaqësoj Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë.

Ju falënderoj për ftesën!

Problemet tona, si Bashkim i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë, për këtë projektbuxhet janë disa, por më lejoni të përqendrohem vetëm te kërkesat që burojnë nga strukturat tona të shëndetësisë në bazë, që kryesisht kanë të bëjnë me pagat.

Rritja e standardit të nivelit të jetesës së punonjësve të sistemit buxhetor në përgjithësi, vendosja e një page dinjitoze të punonjësve të sistemit shëndetësor dhe arsimor, në veçanti. Kërkojmë: rritjen e shtesës së pozicionit të pagës për të gjithë punonjësit e sistemit shëndetësor në masën 20%, sipas përcaktimeve të vendimit nr.13 të datës 31.05.2019 të Këshillit Administrativ të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; rritjen e shtesës së pozicionit të pagës së punonjësve të sistemit shëndetësor, që punojnë pranë spitaleve rajonale, në QSUT dhe në urgjencën kombëtare, në masën 20%; rritjen e vlerës së bonusit për ofrimin e shërbimeve të pandërprera për personelin mjek në masën 20%.

Pak a shumë, këto ishin kërkesat, që ne ngulojmë të parashikohen dhe të jenë të qëndrueshme në buxhetin e vitit 2020, me qëllim që jo vetëm të rregullojmë marrëdhëniet e punës në sistemin shëndetësor, por të pranojmë, në njëfarë mase, edhe “hemorragjinë” e mjekëve dhe infermierëve, që çdo ditë po largohen nga Shqipëria, kryesisht për shkak të pagave të ulëta. Njëkohësisht, qëllimi ynë është të kemi një shpërndarje sa më të drejtë në gjithë sistemin shëndetësor në Shqipëri, të specialistëve dhe të punonjësve të tjerë të shëndetësisë.

Siç e thashë, kemi edhe probleme të tjera, që ndoshta nuk kanë të bëjnë me këtë tryezë, por sidoqoftë ne do t’i depozitojmë këto materiale që kemi në dispozicion, vërejtjet, sugjerimet dhe propozimet që kemi për projektbuxhetin e vitit 2020.

Ju faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, Koço!

Fjala është për ju, zonja Merita.

Merita Xhafaj – Faleminderit!

Në fakt, politikat e pagave nuk i ndjek Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Ne kemi bërë dhe do të bëjmë vazhdimisht sugjerimet tona, por politikat e pagave dhe niveli i pagave janë çështje e një tjetër institucioni, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Ne jemi për mbrojtjen e figurës së mjekut. Kemi dalë edhe publikisht, por edhe realisht në marrëdhënie me gjithë personelin, mjekë, infermierë dhe punonjësit e shëndetësisë, për mbrojtjen e figurës së mjekut, infermierit dhe gjithë punonjësve në sektorin e shëndetësisë.

Për sa i takon ministrisë sonë, jemi gjithmonë të angazhuar, në mbështetje jo vetëm të figurës së mjekut, por edhe të ruajtjes së integritetit, luftës kundër korrupsionit në sistemin e shëndetësisë dhe pastërtisë së figurës të kujtdo që punon në sistemin shëndetësor.

Për nivelin e pagave, natyrisht, në bashkëpunim edhe me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, do të shikojmë mënyrën se si mund të rregullohet struktura, të paktën në spitalet në nivel rajonal, me qëllim mbështetjen dhe përfitimin nga vendimi i Këshillit të Ministrave për shtesën e pagave.

Shumë faleminderit!

Enver Roshi - AWEN, Rrjeti i Fuqizimit të Gruas, Irena Shtraza.

Irena Shtraza – Përshëndetje!

Unë quhem Irena Shtraza dhe përfaqësoj këtu Rrjetin e Fuqizimit të Gruas në Shqipëri, i përbërë nga dhjetë organizata, të cilat punojnë në të gjithë Shqipërinë, kryesisht për të drejtat e gruas, me fokus të veçantë viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe ato të trafikimit. Kështu që, po sjell këtu zërin e dhjetë organizatave anëtare. Në fakt, komentet tona më të detajuara ne do t'i sjellim edhe me shkrim në mënyrë që të kemi mundësi t'i shtjellojmë edhe më tej nënkomision.

Sot duam të theksojmë që Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka një strategji, 2016-2020, që përfundon në fund të vitit 2020, e cila është e lidhur ngushtë me punën tonë, sidomos objektivi i tretë i kësaj strategjie që është i lidhur me forcimin e mekanizmave të referimit për adresimin e rasteve të dhunës në të gjitha bashkitë e Shqipërisë. Ky objektivi kërkon një buxhet shumë të madh, por ndërkohë ka përqindjen më të vogël të buxhetit të dhënë nga shteti dhe është kryesisht mbi 60% i mbështetur nga donatorët. Që në konceptim ka qenë i tillë.

Kjo strategji duhet të mbarojë zbatimin e saj vitin që vjen, por, fatkeqësisht, shumë prej objektivave, për shkak të mungesës së buxhetit, nuk janë zbatuar. Është parashikuar që deri në fund të vitit 2020 të ngrihen dhe të jenë funksionale mekanizmat e referimit në të 61 bashkitë e vendit, ndërkohë jemi në fund të vitit 2019 dhe janë ngritur vetëm 39 mekanizma. Sa funksionale janë, kjo çështje nuk varet nga ministria, por në një farë mënyre ka një hendek shumë të madh midis objektivit që është vënë në strategji. Kjo vjen edhe për shkak të mungesës së buxhetit nga pushteti qendror. Ky është shqetësimi ynë kryesor.

Nuk dua të lexoj 12 nënobjektivat e këtij objektivit, të cilat janë të lidhura ngushtësisht me punën tonë dhe kanë të bëjnë hap pas hapi me të gjithë mbrojtjen dhe paketën e shërbimeve që u ofrohet viktimave të dhunës, por në terma të përgjithshëm është një kërkesë direkte jona që të rritet buxheti për objektivin 3.2 të strategjisë kombëtare. Më pas do të nisim me shkrim të gjitha detajet se ku mund bëhet më shumë, por do të donim të prioritzohej sidomos bonusi social, çështja e strehimit, sepse shpesh kemi viktimë që mbetet në rrugë të pastrehuar. *Shelter*-at nuk janë gjithmonë zgjidhja. Jo gjithmonë mund ta strehosh një grua me fëmijët në *shelter*. Sigurisht, edhe po të punësohet është ndihmë shumë e madhe, por përsëri nuk do të mund ta përballonte dot pagesën e qirasë. I gjithë subvencionimi që mund të bëhet për kreditë e buta për viktimat e dhunës duhet priorizuar.

Ne kemi akoma disa viktime, të cilat vërdallisen dyerve të bashkive dhe mbeten në mes të rrugës për shkak se nuk kemi ku t'i çojmë.

Enver Roshi – Faleminderit, Irena!

Fjala është për ju Merita.

Merita Xhafaj - Faleminderit, zoti kryetar!

Nuk dua t'i hyj këtij diskutimi, por besoja shumë që do të kishte një propozim konkret. Mekanizmat e referimit nuk kanë lidhje fare me projektbuxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Në qoftë se do të flasim për mekanizmat e referimit, janë vërtet 39. Ju kemi dërguar raportin e funksionimit të mekanizmave të referimit dhe jemi në pritje të komenteve tuaja, por që akoma nuk kanë ardhur. E kemi konsultuar edhe me grupet e interesit.

Mekanizmat e referimit funksionojnë në nivel vendor. Në qoftë se zonja e UN Women u përgjigj shumë mirë për buxhetimin gjinor, është pikërisht buxheti gjinor ai që mbulon edhe politikat; këtë politikë që ju thoni dhe atë objektiv dhe indikator që ju thoni. Kjo është e shënuar në projektbuxhetin e ministrisë sonë, por edhe në projektbuxhetet vendore.

Në këtë pikë unë do të kërkoj nga Komisioni për Shëndetësinë dhe Mbrojtjen Sociale informacion për projektbuxhetin e pushtetit vendor. Në asnjë nga kërkesat nuk ka kërkesë për zbatim të politikave sociale. Pas analizës që kemi bërë më rezulton që nga të gjitha bashkitë nuk kërkohen fonde të dedikuara nga buxheti i shtetit për shërbimet sociale.

Shërbimet sociale janë pjesë e strategjisë së mbrojtjes sociale. Strategjia e mbrojtjes sociale është rishikuar, është në proces miratimi nga qeveria shqiptare dhe është zgjatur afati deri në vitin 2023. Është pikërisht këtu pjesa që ne mbulojmë nëpërmjet fondit social. Shuma e parashikuar për vitin 2020 për ngritjen e shërbimeve dhe mbështetjen e pushtetit vendor nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale për ngritjen e shërbimeve të munguara në bashki është 200 milionë.

Në shërbimet e munguara janë edhe shërbimet për viktimat e dhunës në familje. Ndërkohë, që prej vitit 2017 Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale financon të gjitha qendrat që ofrojnë shërbime kundër trafikimit për pagat e të gjithë personelit dhe shpenzimet për ushqim. Do të thotë që mbulojmë 200 milionë shkojnë për fondin social. Mund të bëhet aplikim.

Po kështu edhe për bonusin social të strehimit. Strehimi është një nga përgjegjësitë e Ministrisë së Financave dhe të Ekonomisë. Paketa e akteve nënligjore për ligjin “Për strehimin social”, ku ne kemi dhënë komentet tona, është në proces miratimi. Në programin nr. 6 për banesat e specializuara me kërkesën tonë janë futur edhe shërbimet sociale duke përfshirë

edhe viktimat e dhunës në familje. Bonusi i strehimit jepet nga bashkia. Në këtë kontekst ne do të negociojmë me pushtetin vendor. Nesër do të zhvillojmë një konferencë të madhe, ku ju ftojme edhe ju të merrni pjesë (bëhet në sallën e katit të dytë të ministrisë sonë), e thirrur nga ministrja Manastirliu për lançimin e fondit social. Janë 14 bashki, të cilat përfitojnë nga fondi social, sipas planeve sociale lokale të miratuara dhe aplikimeve të tyre.

Faleminderit!

Enver Roshi – Po.

Elira bode Faleminderit, kryetar!

Kam një ndërhyrje të vogël.

Në fakt, zonja Xhafaj e përmendi vetë, sepse unë nuk e prisja. E kërkoja fjalën para se ajo të arrinte te paketa e akteve nënligjore për ligjin “Për strehimin social”. Në një seancë dëgjimore që u zhvillua dje me Shoqatën e Kryetarëve të Bashkive, kryetari i shoqatës tha që për zbatimin e ligjit “Për strehimin social” jemi duke pritur miratimin e akteve nënligjore. Ligji është kaluar para një viti në parlament, por ende nuk kemi akte nënligjore. Është lajm i mirë që qenka në miratim e sipër. Tërheqim vëmendjen të ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E nderuar, seanca është publike. Ne kërkojmë të miratohet sa më shpejtë në mënyrë që të fillojë zbatimi i ligjit.

Faleminderit!

Halil Jakimi – E konsideroj jashtëzakonisht të rëndësishme punën që bëjnë shoqatat dhe organizatat e ndryshme në fuqizimin dhe rolin e gjinisë femër. Unë kam qenë anëtar këshilli në bashkinë e Bulqizës dhe kam parë se (është e vërtetë ajo që u parashtrua) nuk trajtohen ose nuk ka fonde të mjaftueshme për të trajtuar viktimat e trafikimit, viktimat e dhunës në familje me urdhër mbrojtjeje nga gjykata apo dhe raste të ndryshme. Komisioni i Shëndetësisë edhe ministria (normalisht që e ka Ministria e Ekonomisë) duhet të japin më shumë shtysa dhe propozime konkrete që kryetarët e 61 bashkive të kenë një strategji konkrete për t’i trajtuar këto shtresa. Të mos jenë të fokusuar vetëm në kërkimin e fondeve për rrugë, ujësjellës, shkolla, duke lënë pas dore vëmendjen ndaj këtyre viktimave të trafikuar apo të dhunuara, sepse roli i tyre është jashtëzakonisht ndërgjegjësues, sensibilizues dhe orientues. Unë mendoj që shërbimi social rajonal dhe shërbimi social në bashki, me ndihmën e ministrisë dhe qeverisë shqiptare, duhet të kenë një strategji përkatëse për fondet.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, **Halil!**

Fjalën e ka përfaqësuesi i Shoqatës së Jetimëve të Shqipërisë. Të ftuar janë Lulzim Resuli dhe zoti Endri Reka.

Lulzim Resuli – Më lejoni t’ju përshëndes dhe falenderoj për ftesën!

Së pari, dëshiroj t’ju them që e kemi ngritur edhe më herët si çështje primare ndryshimin që duhet bërë në statusin e jetimit për shkak se pika 1 e ligji “Për statusin e jetimit” e bën shumë të mbyllur çështjen e personave, të cilët mund të përfitojnë statusin e jetimit. Kjo çështje na ka hapur një problem shumë të madh, sepse sot rreth 1000 persona e kanë statusin e jetimit, kurse 28 mijë të tjerë jo. Këto problematika sjellin që jetimët që jetojnë në familjet e tyre janë të pambrojtur pambështetur dhe të diskriminuar.

Kemi 3 vjet që kërkojmë nga Ministria e Arsimit mbështetje për rimbursimin e teksteve shkollore për jetimët, të cilët nuk kanë statusin e jetimit. Ngërçi i madh që ekziston në ligjin për statusin e jetimit nuk i lejon ata për rimbursimin e teksteve shkollore, qofshin në shkollë 9-vjeçare, qofshin në shkollë të mesme. Po ashtu, për shkak se nuk kanë statusin e jetimit mbeten pa u trajtuar me bursë profesionale dhe bursë për shkollën e lartë, një pjesë e mirë e studentëve, të cilët duan të vazhdojnë universitetin. Ky është një problem shumë i madh që ende nuk po gjen as mbështetje dhe as zgjidhje.

Gjithashtu, kryefamiljaret e veja që kanë fëmijët në shkollë hasin një problem shumë të madh për sa i përket pagesës së tarifës së universiteteve, çka i rëndon pa fund buxhetit të këtyre familjeve në nevojë.

Një problem shumë i madh, që e kemi prekur dhe hasur në mënyrë të vazhdueshme, është strehimi. Ka ende jetimë, që kanë arritur stadin për të kaluar jo familjet e tyre, por edhe fëmijët e tyre, të pastrehë dhe që gjenden në rrugë të madhe. Vetëm disa politika në disa bashki, të cilat kanë potencial apo mundësi, kanë plotësuar apo dubluar me bonus qiraje, ndërsa të tjerë enden rrugëve të pastrehë.

Ka disa kategori të jetimëve me status, të cilët janë bartur dhe kanë dalë nga jetimoret. Ky numër vazhdon të rritet teksa ende nuk është vënë dorë për t’i mbështetur këta që kanë qenë dhe mbi të gjitha edhe ata që vijnë më pas. Ky është një problem shumë i madh. Një numër i madh i jetimësh enden të pastrehë dhe nuk dihet fati i tyre.

Një problem tjetër i madh është mbështetja që u duhet dhënë grave të veja kryefamiljare pa mbështetje, të cilat orvaten pa fund në dyert e bashkive për të marrë një vërtetim papunësie. Mendoni sa e vështirë është të kërkojë një ndihmë sociale. Kryefamiljarët e papunë kanë fëmijët e tyre mbi shpatulla. Ata detyrohen t’i nxjerrin fëmijët e tyre në punë të zezë duke i hequr nga shkolla ose nuk mund të marrin ndihmën ekonomike.

Të gjitha këto vështirësi, por edhe orvatjet për përfitimin e pensionit të baballarëve të tyre, në rastet kur kanë qenë të siguruar, që u vonohen pa fund, na hapin një problem shumë të madh për sa u përket kategorive të jetimëve që ne mbulojmë. Nëse statusi i jetimit nuk do të ndryshojë, pra neni 1, ne do të vazhdojmë të njëjtën orvatje për shkak se vihet barriera: nëse je jetim me status mund të përfitosh benefitet, nëse nuk je jetim me status nuk njihesh fare si jetim. Kjo është për të ardhur keq. Fëmijët pa prindin, babain, sot nuk njihen si jetim. Ky është problemi madhor që ne kërkojmë të zgjidhet sa më shpejtë.

Enver Roshi – Fjala është për ju, Merita!

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, kjo është një kërkesë e drejtë. Është një ngërç që ministria jonë e ka për detyrë ta zgjidhë pjesën e statusit të jetimit.

Unë e mbështes zotërinë totalisht, por këtu kemi një ngërç, që do ta zgjidhim patjetër, sepse është domosdoshmëri.

Bursat e shkollave janë përgjegjësi e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Arsimit, të cilat mbulojnë arsimin profesional. Ne, si ministri përgjegjëse për mbrojtjen e të drejtave të të gjitha grupimeve vulnerabël, do të negociojmë me të dyja ministrinë, që të gjejmë zgjidhje, por ngërçi vjen gjithmonë nga pjesa e statusit të jetimit. Në momentin që bëhet ndryshimi, sikurse e shprehu edhe zotëria, janë edhe benefitet e tjera.

Pjesën e përfitimit të ndihmës sociale të të vejave apo orvatjet për pensione duhet t'i koordinojmë me ministrinë e tjera. Mua më ngelet vetëm të angazhohem për ta ndjekur këtë çështje, sepse jetimët kanë nevojë për më shumë mbështetje.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – A do të bëhet projektligj i ri për statusin e jetimit?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo.

Dakord.

Mund ta realizojmë ne nga ana ligjore ndryshimin që kërkojnë?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita – Unë e pranova që zotëria ka të drejtë për këtë pjesë. Për shkak të eksperiencës së punën time në atë vend, personalisht, por edhe si përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale sot këtu, angazhohem të zgjidh problematikat që rrjedhin nga ndryshimi i këtij neni për statusin e jetimit, sepse realisht ajo ka një faturë financiare jo të vogël, por, pa dyshim, është një grupim që ka nevojë për mbështetjen e shtetit. Në këtë kontekst jemi të angazhuar ta zgjidhim këtë problem.

Faleminderit!

Enver Roshi – Faleminderit, Merita!

Të falënderoj, Lulëzimin, pasi përfaqëson një nga kontingjentet më të dhimbshme të shoqërisë, jo vetëm këtu, por në të gjithë botën, për të cilin kërkohet impenjim nga e gjithë shoqëria!

I falënderoj për vëmendjen Meritën dhe Ministrinë e Shëndetësisë dhe Punëve Sociale, në mënyrë që të jepet sa më shpejt statusi i jetimit, që problematikat e tyre të zvogëlohen sa më shumë dhe integrimi në shoqëri të jetë në shkallën më të lartë.

Ilir Pendavinji – E falënderoj zotin Resuli që solli në vëmendje diçka të mirë, por edhe drejtoreshën, zonjën Xhafaj, e cila pranoi se duhet bërë më shumë, sepse deri tani nuk është bërë!

Ne si komision përgjegjës, për sa i përket kësaj pike, duhet të bëjmë një takim të posaçëm për t'u marrë me statusin e jetimit, që t'u krijojmë lehtësira, sepse përveç se janë të vuajtur, edhe ekonomikisht nuk janë në gjendjen që duhet. Pra, duhet t'u vijmë në ndihmë në të gjitha format. Duhet të gjejmë një mekanizëm ndërmjet shoqatave, komisionit tonë dhe ministrisë së posaçme. Sado që të jetë fatura, është një grupim me fëmijë që, e kanë apo nuk e kanë statusin e jetimit, pa një prind, janë jetim. Statusi është thjeshtë i shkruar në letër. Jetim nuk je kur plotëson letrat, por kur nuk ke prindër. Ne si komision duhet ta marrim në konsideratë qasjen që na solli zoti Resuli dhe të gjejmë një mekanizëm me ministrisë për të ecur përpara me këtë punë.

Faleminderit!

Enver Roshi – Sapo e theksuam dhe mbështetja nga ana jonë është maksimale.

Fjalën e ka përfaqësuesi i grupimit të sindikatës së organizatave me aftësi të kufizuara, zoti Sinan Tafaj, të cilin e njoh prej vitesh, që kur isha student. Sinani është i njohur dhe shumë aktiv në grupin e shoqatave me aftësi të kufizuara.

Fjala për ju, Sinan.

Sinan Tafai – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zotërinj deputetë!

Kam edhe autorizimin e kryetarit të Shoqatës së të Verbërve, zotit Hysa, për t'i parashtruar gjërat në një linjë, për të mos i përsëritur dy herë.

Së pari, do të filloj me një kërkesë disi të veçantë, të nderuar zotërinj deputetë, që komisioni juaj të bëjë një mbledhje të posaçme për të analizuar, trajtuar dhe vlerësuar situatën e lirive dhe të të drejtave themelore të personave me aftësi të kufizuar në Shqipëri në bazë të

gjetjeve, konkluzioneve dhe rekomandimeve të Komitetit të Kombeve të Bashkuara për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara.

Në fund të gushtit Komitetit i të Drejtave të Kombeve të Bashkuara për Personat me aftësi të Kufizuara ka marrë në analizë raportet e qeverisë shqiptare dhe raportet alternative për situatën e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, nga të cilat ka arritur në disa konkluzione dhe ka dhënë rekomandime të rëndësishme, të cilat meritojnë të trajtohen nga Kuvendi, pasi prekin thellësisht liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, për të cilat vetëm Kuvendi është kompetent dhe në gjendje për të mbajtur një qëndrim.

Për t'u kthyer në çështjet konkrete të buxhetit, unë do të parashtroj vetëm dy probleme:

Së pari, atë të shërbimeve për të verbrit në Shqipëri. Ka rreth 5 vjet që nuk financohen shërbimet e posaçme për të verbrit. Ky komunitet, me përpjekjet e tij, ka ngritur një qendër kombëtare në Vaqar, e cila pati një mbështetje të pjesshme nga ministria përgjegjëse, por më shumë nga donacionet e organizatave të të verbërve të vendeve europiane dhe të komuniteteve të të verbërve të Shqipërisë. Kjo qendër ka një sipërfaqe prej 6500 metra katrorësh ndërtim dhe 13 mijë metra katrorë sipërfaqe trualli. Ka rreth 120 shtretër, 23 salla të posaçme për të ofruar shërbime dhe një mensë me kapacitet rreth 200 vetë; është e pajisur me mbi 1 milion euro pajisje, të cilat janë sponsorizuar nga homologët tanë perëndimorë, por ka 5 vjet që qëndron pothuajse e pa përdorur ose përdoret për aktivitete të vogla të organizatës. Të verbrit sot marrin vetëm një shërbim minimal të librave në audio, të cilat përballohen nga kuotizacioni i tyre i anëtarësisë, por nuk marrin shumë prej shërbimeve që kanë marrë më parë. Komisioni juaj në vitet 2016–2017 i ka propozuar Komisionit të Ekonomisë të mbahet parasysh ky financim. Këtë vit besoj se keni marrë një letër nga zoti Hysa, i cili ka kërkuar mbështetjen tuaj, që t'i rijepet edhe një herë Komisionit të Ekonomisë, duke shpresuar që situatat kanë ndryshuar dhe do të jenë më të favorshme, nisur edhe nga shpjegimet që janë dhënë në atë dokument, të cilin besoj se e keni marrë.

Është shumë e rëndësishme të kuptohet që nuk është një çështje vullneti për t'u dhënë si një e drejtë, por duhet realizuar një e drejtë që është njohur në vitin 1996 për statusin e të verbërve. Pra, është një detyrim i përcaktuar në ligj, të cilit ministria përgjegjëse i është shmangur prej 5 vjetësh dhe vazhdon t'i shmanget.

Do të ishte mirë të bëhej, sepse ajo godinë me një investim prej rreth 4 milionë eurosh, po rrënohet dita-ditës, ndërkohë që shumë shtresa të tjera nuk kanë arritur t'i krijojnë këto mundësi. Ne i kemi krijuar vetë. Shteti kërkon mjedise, hapësira dhe investime për t'i bërë, ndërsa në komunitetin e të verbërve kjo ekziston, por ka një ngërç, të cilin jua kanë shpjeguar në letrën që ju kanë drejtuar.

E dyta, nuk është vetëm për të verbrit, por është edhe për grupet e tjera të njerëzve me aftësi të kufizuara. Janë krijuar disa detyrime të prapambetura për shkak të mosrespektimit të vendimit të qeverisë për pagesat e aftësisë së kufizuar për periudhën 2005–2010. Që nga dhënia e statusit të të verbërve, paraplegjikëve dhe grupeve të tjera me ligjin nr. 9355, datë 10 mars 2005, pagesat e për njerëzit me aftësi të kufizuara janë indeksuar me rritjen e pagës minimale. Në fakt, nuk u bënë mirë në atë periudhë dhe ne kemi kërkuar, kemi bërë procese gjyqësore kundër Ministrisë së Punës dhe Ministrisë së Financave. Gjykatat nuk e çmuan të arsyeshme që ne të bënim gjyq me qeverinë dhe na kthyen të bëjmë gjyqe me komunat dhe bashkitë. Fakti që me reformën territoriale këto u reduktuan, na ka lehtësuar punë, sepse në atë kohë ishin 380 e ca bashki dhe komuna. Tani po e vazhdojmë me bashkitë duke i grupuar. Aktualisht mund të jenë rreth 10 apo 15 gjyqe të paekzekutuara, që kapin një vlerë rreth 1 milion euro. Pra, janë gjyqe me pjesëmarrje rreth 50 apo 100 personave paditës, të cilëve mesatarisht u takojnë mbi 100 euro.

Siç e dini, në Gjykatën e të Drejtave të Njeriut në Strasburg, drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar. Meqenëse këto vendime nuk po ekzekutohen pre shumë vitesh, do të detyrohemi t'i drejtohem Gjykatës së Strasburgut. Do të ngrihen me dhjetëra procese gjyqësore, veç shumë të tjerave që janë ngritur. Është mirë që qeveria ta paguajë këtë detyrim pa qenë nevoja për t'i kërkuar gjyqësisht, por meqenëse shifra mund të shkojë rreth 70 milionë euro dhe ministria ka refuzuar që kjo çështje të zgjidhet me ligj, mbetet ta zgjidhim me gjyqe.

Në buxhetin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale këto mund të parashikohen në zërin 602, ku realizohen ekzekutimet e detyrimeve gjyqësore. Ky fond është i nevojshëm, sepse bashkitë dhe komunat nuk janë fajtorë për këtë detyrim të prapambetur, por është një deficit i krijuar nga transfertat e pakushtëzuara te zëri 606. Për pasojë, këto duhet të paguajë duhet t'i paguajë ministria përgjegjëse, që i ka lënë mangut, pavarësisht se ne po i ngremë paditë kundër bashkive.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj se ministria është këshilluar keq nga specialistët duke ecur me shpresë se, meqenëse kanë kaluar shumë vite, ato do të parashkruhen sipas nenit 112 të Kodit Civil. Kjo nuk është e vërtetë, sepse afati i parashtrimit fillon atëherë kur ke marrë apo duhet të merrje dijeni. Ata nuk kanë marrë dhe nuk duhet të marrin dijeni, sepse nuk janë në gjendje të përlllogarisin çfarë u takon në përqindje, në ngritje dhe në ulje. Tani që bëhen gjyqe, këto bëhen me ekspertë. Pra, është e njëjta gjë si ai që shkon të marrë pensionin dhe nuk është në gjendje të llogarisë pensionin e vet. Pra, nuk mund jenë përgjegjës personat me aftësi të kufizuara, që kujdeseshin a u bë apo nuk u bë rritja në përputhje me parashikimet dhe formulat që ka ligji.

Duke u nisur nga neni 4 i Kushtetutës, ne kemi shtetin e të drejtës dhe çdo qytetar ka sigurinë juridike. Shteti duhet të respektojë të drejtat dhe t’ia japë në kohën dhe në mënyrën që u takojnë. Në kushtet kur këto të drejta nuk janë dhënë, është krijuar edhe një shkelje kushtetues. Unë ju lutem që ministria të marrë parasysh që në zërin e saj 602, aty ku parashikohen detyrimet për shlyerjen e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore, të parashikohet një fond i nevojshëm. Duhet ta parashikojë të paktën 2 milionë euro, sepse janë shumë vendime gjyqësore të paekzekutuara dhe janë në proces shumë të tjera, që të zbutet si proces, pra të mos i drejtohem Strasburgut për të kërkuar masa paralizuese ndaj shtetit shqiptar.

Faleminderit!

Enver Roshi – Fjala për Meritën, në përgjigje të zotit Sinan.

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Me shumë respekt dhe konsideratë për profesor Sinanin, edhe pse kur u takuam më tha: “Nuk duhet të vije ti këtu”.

Unë e kuptoj dhe jam në mbështetje të problematikave të ngritura.

Po e nis me indeksimin, i cili i takon një periudhe tejet të hershme. Nga viti 2013, fatmirësisht, indeksimi është bërë dhe është paguar. I ka takuar një periudhe të mëparshme, por Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale e ka shpjeguar edhe vitin e kaluar, kur kemi bërë diskutimin e projektbuxhetit, edhe një vit më përpara, se nuk mund të parashikojmë dot fonde kur nuk e dimë se sa është vlera që i takon gjithsecilit; ajo që nuk është paguar nga qeveria e mëparshme.

E dyta, fakti që në proceset gjyqësore ka pasur përfaqësues të ministrisë sonë, që kanë dhënë dakordësinë për vendimin e gjykatës, do të thotë se ne e kemi njohur vendimin e gjykatës. Por ligjërisht, sikurse edhe profesor Sinani e di, pasi është jurist, është pikërisht bashkia ajo e cila identifikon në territorin e saj se sa kërkesa ka për ata që nuk kanë përfituar indeksimin e pagesës për atë periudhë, pra për sa vite nuk e kanë përfituar; është pikërisht bashkia, e cila duhet të llojë me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, në mënyrë që vendimet e gjykatave të mund të ekzekutohen. Ne nuk kemi asnjë mundësi të parashikojmë se sa është numri dhe vlera e kësaj pagese, pa e ditur dhe pa pasur një listë të tillë.

Profesor Sinani ka shumë të drejtë që e ngre këtë problem, pasi është shumë i hershëm. Vendimet e gjykatave janë vendime gjykatash dhe është e nevojshme të zbatohen. Ne jemi shumë dakord me të gjithë procesin, por nuk i takon Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, sepse nuk e dimë vlerën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne kemi tavane.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Detyrimet e kujt?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Realisht, vendimet e gjykatës këta i kanë në marrëdhënie me bashkitë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, i detyron bashkitë. Pra, bashkitë janë të detyruara të llobojnë me ministrinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e kanë marrë vlerën; këtë pjesë. Kjo i takon një periudhe të hershme, të mëparshme dhe nuk...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk e di cila është vlera dhe numri i atyre që kanë ngelur pa e marrë indeksimin. Ne nuk mund të bëjmë një përlllogaritje.

Lidhur me qendrën e shërbimit ndaj të verbërve, edhe kjo është një nga problematikat, që, bazuar në legjislacionin në fuqi, është fondi social ai që mbulon shërbimet e munguara. Por më duhet të them edhe faktin tjetër që një pjesë e qendrave dhe shërbimeve janë ngritur me investime të huaja dhe janë të futura në udhëzimin e buxhetit nga Ministria e Financave; ato financohen direkt. Domethënë, te ne vijnë vetëm kërkesat nëpërmjet qarqeve. Aktualisht, bëhen aplikime për ngritjen e shërbimeve të reja nga bashkitë. Ky është ligji ynë dhe, nëse vjen një aplikim për të ndihmuar bashkinë ose për të financuar nga fondi social për shërbimet, natyrisht që do ta mbulojmë. Por në momentin që nuk ka ardhur as nga qarku, as nga bashkia, kjo është direkt në udhëzimin e Ministrisë së Financave. Janë më shumë sesa dhjetë qendra të shërbimeve sociale, të cilat mbulohen financiarisht direkt, pa ndërmjetësimin tonë, pa kaluar nga buxheti ynë, por kalojnë direkt nga buxheti i Ministrisë së Financave.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Rroshi – Vetëm shkurtimisht, ju lutem, sepse jeni jashtë kohës!

Sinan Tafaj – Fare shkurt.

Në të dyja rastet zonja Merita nuk arriti ta ezaurojë në fund.

Së pari, duke filluar nga kjo e dyta, në ligjin nr. 8098 ka një nen 10, ku thuhet: “Ngremë qendrat e pushimit dhe shërbimeve për personat me aftësi të kufizuar”, i ngre qeveria, i administron Shoqata e të Verbërve dhe i financon qeveria. Pra, është e thënë e zeza mbi të bardhë. Kështu që unë nuk e di se çfarë ligji kërkon, se çfarë baze ligjore kërkon të jetë zonja Merita, por ka edhe një vendim qeverie në zbatim të këtij, i cili ka pasur fuqi deri në vitin 2014 dhe nuk është rinovuar më.

Së dyti, lidhur me këtë të dytën, ministria ka refuzuar t'i paguajë, pra t'u përgjigjet pozitivisht kërkesave të bashkive. Ministria i ka vendimet gjyqësore, i ka kërkesat e bashkive dhe sot ato janë rreth 1 milion euro të paekzekutuara. Pra, i ka Drejtoria juaj e Ekonomisë dhe e Financës, ajo e vjetra dhe e reja çfarë keni tani, kërkesat e bashkive. Por në shumicën e rasteve ministria u është përgjigjur në mënyrë negative bashkive duke i lënë ato në ditë të hallit.

Nuk mund të ketë Bashkia e Klosit sot të paguajë 100 milionë lekë të vjetër për detyrimet gjyqësore në zërin "602", kur ata nuk kanë as 20 milionë të vjetër për goma e karburant për veten e tyre. Kështu që duhet të jemi të sinqertë dhe të qartë se këto vendime gjyqësore i janë bërë të qarta ministrisë, janë bërë kërkesa për t'u marrë përsipër shlyerjen e detyrimit, pasi realisht janë detyrime që kanë ardhur nga ky zë. Pra, nuk është faji i bashkive, por i ministrisë.

Pavarësisht se Gjykata e Lartë nuk na lejoi ta bënim gjyqin me qeverinë, në të vërtetë deficit është krijuar pikërisht nga buxheti i ministrisë, sepse ky është një buxhet që shkon direkt nga qeveria, është buxhet qendror dhe jo i bashkisë. Pra, nuk janë fajtorë bashkitë që nuk e ekzekutojnë dot vendimin.

Pa dyshim, gjykata nuk mund të shprehet dhe të thotë që të paguhet në këtë apo në atë zë. Gjykata thotë: bashkia ta paguajë. Pastaj, se si ekzekutohet, ky është një problem që zgjidhet brenda pushtetit.

Faleminderit!

Enver Roshi – Viojmë me Konfederatën e Sindikatave të Shqipërisë.

Fjalën e ka zoti Kolë Nikollaj. Ju ishit edhe ditën e djeshme. Kështu që, ju lutem, sa më shkurt.

Kolë Nikollaj – Përsëndetje, zoti kryetar i komisionit!

Përsëndetje, të nderuar deputetë!

Duke ju falënderuar për mundësinë e pjesëmarrjes në këtë event, dje ishim për dje, ndërsa sot jemi për sot, kështu që besoj se kjo nuk ka të bëjë!

Unë do të jem pak kritizues, sepse do të flas për ato që nuk janë bërë. Po të flas për ato që janë bërë, duhet të ngelem gjatë gjithë kohës këtu.

Analiza dhe miratimi i projektbuxhetit të çdo viti është një akt politik dhe në funksion të zhvillimeve ekonomike të vendit. Dua të vlerësoj punën dhe kontributin e parlamentit, i cili çdo vit ka bërë të mundur prezencën tonë në takime të tilla, si dhe dëgjimin dhe përcjelljen e kërkesave dhe të shqetësimeve tona. Ndryshe ka ndodhur këtë vit me qeverinë, e cila ka manifestuar një terr informativ në lidhje me diskutimin e projektbuxhetit me partnerët socialë. Ky projektbuxhet nuk është diskutuar konform ligjit në asnjë organ dypalësh ose trepalësh, ku

përfshihen qeveria, punëdhënësit dhe punëmarrësit, veçanërisht Këshilli Kombëtar i Punës, i cili është edhe parlamenti i punës, bordi i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Këshilli Administrativ trepalësh i Shërbimit Kombëtar të Punësimit, Këshilli Administrativ i Fondit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor e të tjerë.

Duke u ndier të keqardhur për një veprim të tillë, ku qeveria shqiptare tashmë ka prishur urat e komunikimit me partnerët socialë, dëshirojmë që nëpërmjet këtij komisioni të nderuar t'i bëjmë thirrje edhe një herë qeverisë që të vendosë ura bashkëpunimi me sindikatat, përpara se t'i vendosë ato para faktit të kryer, madje të bashkëpunojë dhe të dialogojë me to, si e vetmja për të ulur dhe për të minimizuar tensionet sociale.

Ne e kemi vlerësuar punën dhe kontributin e qeverisë vite me radhë për të reformuar dhe për të rikonstruktuar aktivitetin ekonomik të shtetit, pavarësisht rezultateve që nuk kanë qenë ato që ne prisnim. Ne duam të shprehim disa vërejtje, të cilat do të ishte mirë që komisioni juaj i nderuar t'i merrte në konsideratë dhe t'ia relatonte qeverisë, me qëllim, së pari, riformatimin e këtij buxheti në aspektin social, në aspektin e punësimit, në aspektin e rritjes së pagave dhe të pensioneve në përgjithësi, si dhe të pagës minimale në veçanti; të rregullimit të transparencës së procesit fiskal, si dhe të rritjes së investimeve në drejtim të përmirësimit të cilësisë së shërbimit për publikun.

Në projektbuxhetin e vitit 2020 të ardhurat buxhetore planifikohen në vlerën 502 miliardë lekë, shpenzimet në vlerën 531,9 miliardë lekë dhe vlera e deficitit buxhetor për vitin 2020 parashikohet rreth 30 miliardë lekë.

Dua të sjell në vëmendjen tuaj se jemi ndër vendet më të varfra të rajonit dhe të Europës me një produktivitet të dobët në fushën e punësimit dhe me një PBB shtatë herë më të ulët sesa ajo e vendeve të Bashkimit European.

Projektbuxheti i vitit 2020 është i vetmi projektbuxhet në vitet e demokracisë, përfshirë edhe vitin 1997, i cili nuk parashikon rritje pagash dhe pensionesh, madje për pagat nuk parashikohet as indeksimi i tyre, detyrim kushtetues ky i qeverisë. Fondi për politika të reja pagash është zero, nga 2 miliardë lekë, që ishte në vitin 2019, vlerë e cila edhe në atë kohë ishte e papërfillshme.

Ne kemi një pagë minimale në vlerën 26 mijë lekë, e cila po krijon probleme jo vetëm në rritjen e varfërisë, por edhe në deformimin e tregut të punës dhe në largimin e të rinjve jashtë atdheut. Ne i kemi kërkuar qeverisë që kjo pagë për vitin 2020 të jetë 33 mijë lekë, ndërsa për vitin 2031 të bëhet 36 mijë lekë. Kjo do të bënte të mundur qëndrueshmërinë e tregut të punës, stabilitetin e skemës së sigurimeve shoqërore dhe do të frenonte emigracionin ose azilkërkimin në vendet e Bashkimit European, sidomos nga të rinjtë.

Problemi më i madh i shqiptarëve në vendin tonë mbetet ende ekonomia dhe kjo është hallka kryesore në zinxhirin e kushteve të Bashkimit European për hapjen e negociatave të vendit tonë. Qeveria shqiptare me një buxhet të tillë që paraqet për vitin 2020, nuk arrin të sigurojë rritjen e arkëtimeve, luftën kundër informalitetin dhe fshehjen e të ardhurave nga biznesi, si dhe ta detyrojë këtë të fundit që të bëjë deklarime reale të fitimeve dhe të pagave të shpërndara.

Ndër vite ne kemi kërkuar një rritje të konsiderueshme pensionesh dhe një status special për moshën e tretë. Në të vërtetë edhe ky buxhet nuk ka asgjë për pensionistët, përveçse një indeksim normal të pavlerë përballë shqetësimeve të tyre shëndetësore dhe ekonomike. Ky buxhet nuk ka parashikuar as bonusin e fundvitit për pensionistët, një e drejtë tashmë e fituar në sajë të kontributit dhjetëvjeçar për ekonominë kombëtare.

Na duket interesante rritja e shpenzimeve me 2,3% ose 532 miliardë lekë, në një kohë kur ne nuk kemi rritje pagash për administratën publike, për arsimin, shëndetësinë, policinë, ushtrinë e të tjera.

Në buxhet parashikohet hapja e 35 mijë vendeve të reja të punës, por nuk shpjegohet dhe nuk i referohet...

Enver Roshi – Ju lutem, referojuni vetëm problemeve të shëndetësisë!

Kolë Nikollaj – Të gjitha këto kanë të bëjnë me fushën sociale; për shëndetësinë folëm dje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se e kemi për problemet sociale sot.

Enver Roshi – Mirë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kolë Nikollaj – Unë jam i saktë...

Edhe një herë, në buxhet parashikohet të hapen 35 mijë vende pune të reja, por nuk shpjegohet... Edhe duke iu referuar logjikës ekonomike, nga interpretimi i buxhetit nuk del i vërtetë se ku, si dhe sa vende pune do të hapen. Për këtë aspekt ky buxhet nuk ka asnjë zë të përcaktuar dhe më dyshuese kjo vlerë bëhet kur kemi ulje të planifikimit të rritjes ekonomike nga ajo e vitit 2019, nga del e pakuptimtë të kemi ulje të rritjes ekonomike dhe hapje të konsiderueshme të vendeve të reja të punës.

Të gjithë jemi të shqetësuar për problematikën që për vite me radhë ka shfaqur sektori i arsimit, i cili është prioritet kombëtar dhe jo vetëm i qeverisë. Në buxhetin e këtij viti fondi për arsimin rritet me vlerën 3,33 miliardë lekë, e cila shkon tërësisht për të mbajtur premtimin e qeverisë për libra falas për nxënësit, ndërkohë që nuk kemi asnjë qindarkë të planifikuar për

kërkimin shkencor, laboratorët, kushtet e punës mësimdhënëse, për përmirësimin e kushteve të jetesës së nxënësve, studentëve e të tjera.

Ky projektbuxhet nuk parashikon asnjë rritje për sa u përket paketave të ndihmës sociale, asistencave sociale, bonuseve për pensionistët... Është ulur kompensimi për ish-pronarët dhe të dënuarit politikë, si dhe është e paqartë se si do të shlyhen detyrimet e prapambetura për vendimet gjyqësore, të cilat sapo u përmendën, ashtu edhe detyrimet e tjera për shpronësimet nga Ministria e Infrastrukturës.

Ky buxhet ka reduktuar ose ka mbajtur në stanjacion investimet publike, të cilat do të ndikojnë negativisht jo vetëm në rritjen ekonomike, por edhe në çështjet e punësimit dhe të konsumit.

Në këtë buxhet bëhen lehtësi fiskale për industrinë e automobilave, e cila është inekzistente, përveç disa rasteve sporadike në Fier, ndërkohë që nuk ekziston asnjë lehtësi fiskale për industrinë e fasonëve, rentën minerare, arsimin dhe shëndetësinë, si një shërbim publik i detyrueshëm për qytetarët, për biznesin e vogël, për biznesin rural e të tjera. Megjithatë bëhet një ulje e tatimit vetëm për makineritë e industrisë së fasonëve, fasonet në përgjithësi e kanë tatimin 15%, shifër kjo asfiksuese për këtë sektor.

Na duket e pakuptimtë, për të mos thënë paaftësi qeverisëse, që treguesi me pritshmëri më të ulët në këtë buxhet është TVSH-ja. Të ardhurat nga TVSH-ja, sipas buxhetit, pritet të jenë 152,2 miliardë lekë, shifër kjo me të njëjtin nivel të vitit 2019 në vlerë nominale. Ne e dimë se TVSH-ja është indikator që mat direkt konsumin, por gjatë vitit 2019 grumbullimi i TVSH-së është tkurrur me 22% nga efektet që ka dhënë përdorimi i investimeve të huaja, i gazsjellësit TAP, i hidrocentraleve e të tjera. Ne e kuptojmë se kjo performancë e dobët e grumbullimit të TVSH-së sjell dobësim dhe tkurrje të të ardhurave në tërësi, gjë që ndikon në uljen e shpenzimeve që qeveria do të bënte për pagat, pensionet, programet sociale, me synim ruajtjen dhe balancimin e parametrave të buxhetit.

Edhe shpenzimet kapitale në këtë buxhet ulen, në krahasim me vitin 2019, me një rënie prej 4,2% në raport me PBB-në. Duket qartë se shpenzimet kapitale do të zbresin në 4,7% të PBB-së nga 5,1%, që ishin parashikuar për vitin 2019.

Disa vite rresht rezultati financiar i ISSH-së është pozitiv dhe kjo krijon mundësinë për të rritur pensionet, por qeveria, në mënyrë jo të ndershme, abuzon me dhënien e pagesave kalimtare, pensione të parakohshme, mospagesë e sigurimeve shoqërore për grupe të caktuara nga administrata publike e të tjera, si dhe justifikohet me krijimin e mundësisë për shtimin e rezervës garantuese të pensioneve, e cila edhe mund të shtyhet për t'u garantuar një periudhë më afatmesme. Krimi i rezervës garantuese të pensioneve, duke thithur çdo vit tepërcat

financiare, që krijon ISSH-ja, pa rritur pensionet në mënyrë të pandershme, keqpërdoret nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave, e cila është në konflikt interesi me ISSH-në.

Enver Roshi- Ju lutem, kërkesa konkrete, sepse humbasim edhe ne orientimin!

Kol Nikollaj- Ky është aspekti social i buxhetit. Nëse këto që thashë unë nuk qëndrojnë, është diçka tjetër, por, nëse qëndrojnë, ato kanë të bëjnë me problemin social.

Enver Roshi- Të gjitha qëndrojnë, por humbasim orientimin dhe ne jemi të fokusuar që të ndihmojmë edhe ty dhe të gjithë punonjësit e shëndetësisë.

Kol Nikollaj – Ne vlerësojmë se ky projektbuxhet nuk do të sjellë ndryshim në rritjen e punësimit, në rritjen e pagave, pensioneve, rritjen e asistencës dhe përkrahjes sociale, paketës sociale, bonuseve dhe shpërblimeve të tjera të njohura me ligj.

Mosrritja e pagës minimale është një hap prapa në këtë buxhet, i cili do të krijojë probleme zinxhir në ekonominë e vendit. Kjo do të rrezikojë skemën e re të pensioneve, nuk do të nxisë konsumin e popullatës dhe, për rrjedhojë, nuk do të kemi rritje reale dhe të qëndrueshme ekonomike. Edhe me këtë buxhet, fatkeqësisht, nuk do të ndryshojë vija e kuqe, poshtë të cilës pjesë e konsiderueshme shqiptarësh jetojnë në një varfëri absolute dhe ekstreme.

Enver Roshi- Zoti Kol, ju falënderoj për të gjithë rezymenë e gjatë që bëtë!

Kol Nikollaj- Lidhur me çështjen e pagave, sepse i dëgjova kolegët e BSPSH-së, të cilët u larguan, kur thanë që ministria nuk mban përgjegjësi për pagat, ne këtu vijmë për një qeveri të unifikuar dhe Ministria e Financave duhet të ishte këtu sot dhe dje, sepse nuk mund të jenë vetëm përfaqësuesit e ministrisë, të cilët e quajnë veten të papërgjegjshëm për pagat, që normalisht janë punëdhënës dhe e kanë për detyrë të rritin pagat e punonjësve. Kështu që nga Merita presim vetëm rritjen e pagave për infermierët, mjekët dhe nuk duam asgjë tjetër. Në qoftë se na i thoni këto, jemi shumë të kënaqur. Sugjerimet tuaja qëndrojnë, por besoj se keni qenë edhe te Komisioni i Ekonomisë dhe i keni ngritur edhe atje problemet.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj- Faleminderit, zoti kryetar!

Unë kam qenë para disa ditësh te kongresi i Konfederatës dhe më vjen shumë mirë që jam përfaqësuese e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale te komiteti trepalësh. Realisht, jam shumë e hapur për të gjitha kërkesat që mund të vijnë për diskutimin dhe konsultimin e projektbuxhetit, por nuk është vënë në axhendë asnjë lloj kërkesë që të diskutohet në komitetin trepalësh.

Nga ana tjetër, konsultimet natyrisht kanë qenë detyrim dhe janë bërë me të gjitha grupet e interesit, madje janë bërë në fazën e parë dhe të dytë, sepse kjo është faza e tretë e projektbuxhetit të vitit 2020. Në këndvështrimin dhe kontekstin e të gjithë projektbuxhetit të

qeverisë nga pikëpamja sociale, natyrisht, mbrojtje sociale quhen edhe marrëveshjet e pensioneve bilaterale, por nuk janë në fushën e shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, unë nuk mund të flas dot për projektbuxhetin e të gjithë qeverisë. Ajo që ju keni problem për pjesën e pensioneve, unë ju garantoj një gjë: ne kemi përgatitur për herë të parë në Shqipëri planin kombëtar të veprimit për moshën e tretë dhe ky plan ka brenda edhe indeksimin e pensioneve, natyrisht kundrejt afateve kohore, në të cilat shtrihet ky plan dhe të gjitha problematikat e tjera.

Lidhur me pagën minimale, ju e dini më mirë sesa unë, unë nuk mund ta marr përgjegjësinë për të gjitha institucionet, për këtë dua të kërkoj mirëkuptimin tuaj, sepse përgjegjësitë që ka Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë në fushën e saj të mbulimit. Edhe për pagat, unë thashë disa mënyra dhe variante, me ndryshimet e strukturave brenda spitaleve rajonale, me qëllim përfitimin e shtesës apo mbrojtjen e figurës së mjekut, por ju e dini më mirë sesa unë që propozimet dhe politikat e pagave janë politika të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë. Pa dyshim që ne do të bëjmë punën tonë, por përgjigjemi për fushën e mbulimi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale.

Faleminderit!

Kol Nikollaj – Nuk jam shumë i kënaqur, unë mund të jem më i vjetri këtu që kam 10 vjet që vij, ndërsa të tjerët, në sajë të rotacioneve politika, kanë ardhur më vonë, sepse është hera e parë që ky buxhet nuk diskutohet as në fazën e parë, as në të dytën dhe as në të tretën. A është diskutuar në Këshillin Kombëtar të Punës?

Merita Xhafa – Jo.

Kol Nikollaj – Është detyrim ligjor dhe kushtetues që të mos vijë në parlament pa kaluar në Këshillin Kombëtar të Punës. Në të gjitha bordet trepalëshe, ku sindikatat janë pjesë e saj, nuk flas për shoqërinë civile, sepse ajo ju bën fresk juve e të tjerëve, por flas në mbrojtje të punëtorëve shqiptarë, dhe në 6 bordet administrative, ku sindikatat janë pjesë, nuk është diskutuar. Është dashur të diskutohet që në fillim në Këshillin Kombëtar të Punës, ku janë 6 komisione, prandaj vijmë sot e nxjerrim të gjithë dufin, sepse duhet të kishim punuar gjatë gjithë vitit që sot të duartrokitem dhe të thoshim: “Kjo është realizuar, këtë do ta bëjmë dhe kjo premtohet se do të bëhet”. Me këtë buxhet ka pasur terr informativ, ndoshta kjo ka ardhur për shkak të ndryshimit të varësisë, sepse Ministria e Punës u shkri, e mori Ministria e Financave, tashmë Ministria e Financave nxjerr të papërgjegjshme Ministrinë e Shëndetësisë dhe ne, sindikatat, edhe për zakon, shkonim gjithmonë në atë ministri. Ministria e Financave është në konflikt të hapur interesi në marrëdhëniet me punën, sepse nuk mund të ndjekë edhe problemet e punës dhe të financojë e të buxhetojë punën. Kështu që, të dashur deputetë, ju lutem shumë, ngrini zërin që të ringrihet Ministria e Punës, sepse jemi i vetmi vend në Europë,

nuk e di për në botë, që jemi pa Ministri Pune! Ajo duhet t'i rregullojë të gjitha këto problematika. Nëse nuk kemi Ministri Pune dhe Ministria e Financave merr përsipër të kryejë marrëdhëniet e punës, arsimi dhe formimi profesional do të shkojnë pikiadë. Do ta shihni vitin tjetër se si do të jetë ky arsim, i cili ishte prioritet kryesor dhe një punë e shkëlqyer që kjo qeveri bëri, ashtu siç ishte reforma e pensioneve, një reformë e shkëlqyer që bëri kjo qeveri. Për një vit ose dy vjet pensionet do të ulen dhe nuk do të ngrihen, sepse nuk ka të ardhura, qoftë për plakjen e popullatës, qoftë për tatimet, qoftë për ngushtimin e popullsisë e me radhë.

Halil Jakimi- Faleminderit!

Zotëria bëri një parashtrim të përgjithshëm të të gjitha problematikave sociale të parashtruara, por prisja një trajtim ose një propozim konkret dhe çfarë kërkesash ka ndaj qeverisë në lidhje me minatorët. Unë quhem Halil Jakimi, jam nga Bulqiza, e di që jeni përfaqësues i sindikatës, por më i njohur për minatorët. Ka vite që e mbroni çështjen e minatorëve, por herë pas here jeni akuzuar nga të gjithë, si sindikatë, palë me qeverinë, me të gjitha qeveritë, dhe, absolutisht keni zhgënjyer në masë të madhe të gjithë minatorët, të mos flasim për emisionet që ju bëjnë dhe dilni me prona e pasuri të paluajshme saqë Zoti e merr vesh. Zoti Kol, unë e kam trajtuar edhe në parlament, si deputeti i ri, si djalë minatori dhe si përfaqësues i asaj zone, kur ju keni ardhur në Bulqizë dhe keni mbajtur një protestë në vitin 2018, ku ndodhi dhe incidenti në sheshin e Bulqizës...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, mos ndërhyj, sepse nuk e ndërpreva zotërinë!

Si keni menduar ta zgjidhni problemin e ligjit, që kaloi në korrik të këtij viti, për trajtimin suplementar shtesë për minatorët, naftëtarët dhe metalurgët? Nuk e besoj se ti, si përfaqësues i sindikatës, të jesh i kënaqur nga ligji që kaloi. A keni ndër mend të zhvillonin protesta apo si do ta zgjidhni këtë problem? Në dijeninë time, para një jave u krijua një Sindikatë e Bashkuar e Minatorëve të Bulqizës pa varësi nga asnjë sindikatë dhe kanë bërë shumë mirë, e kanë regjistruar në gjykatë, unë u uroj shumë suksese, sepse nuk besojnë tek asnjëri prej jush. Mos e merrni personale, por ne shohim që në kongres qeveritarët vijnë te ju, ju shkonin në mbledhjet e partisë, të gjithë jeni bashkë dhe hajde gjeje se ku është kjo. A ka ndonjë zgjidhje për statusin e shtresës së minatorëve, të cilët janë shtresë sociale dhe në nevojë?

Klodiana Spahiu- Në respekt të fjalës së kolegut dhe kolegëve që diskutuan më parë, e kuptoj shumë drejt shqetësimin tuaj, por besoj se nuk është momenti të diskutohet një problem i tillë. Ju keni të drejtë të bëni interpelancë, të kërkonin seanca dëgjimore, për të cilat kemi qenë të gjithë të gatshëm si komision, por në këtë moment po diskutohet buxheti dhe nuk besoj se duhet të hyjmë në këto problematika.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Megjithatë, ju keni mendimin tuaj.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Koci Tahiri – Zakonisht nuk shquhem për këto punë, por, meqenëse kam qenë edhe unë pjesëtar i lëvizjes sindikaliste, unë them që qoftë ju, qoftë BSPSH-ja, nuk e keni luajtur rolin ashtu siç duhet dhe jam plotësisht dakord me zotërinë, i cili thotë që në një farë mënyre jeni bërë palë. Edhe ne atëherë palë ishim bërë, sepse, po të mos ishim bërë palë, nuk do të ishte në këtë gjendje, por duhet që ju, në mënyrë të veçantë për minatorët, ta ngrini zërin më shumë. Unë nuk them që nuk keni punuar, por kur shoh që në podiumet tuaja rreshtohen qeveritarët, kjo nuk shkon. Prandaj edhe unë dua që ta ngrini zërin më shumë, sepse keni rënë në heshtje.

Ju faleminderit!

Kol Nikollaj – Ndjesë, zoti kryetar, bashkohem edhe me opinionin e nënkryetares, por përderisa këtu u ngrit një problem, i cili nuk ka të bëjë vetëm me temën e ditës, por edhe një lloj akuze indirekte, së pari, dua t'i informoj se Konfederatat e Sindikatave është një organizatë shoqërore, e cila funksionon si bashkim vullnetar i anëtarëve të saj, që përfshin rreth 130 mijë punëtorë nga të gjitha profesionet, këta i grupojmë në 10 federata profesionale, ku çdo federatë ka 3-5 sindikata profesionale, ku një nga këto është edhe ajo e minatorëve, që është shkalla e tretë apo e katërt e rendit hierarkik në Konfederatën e Sindikatave. Unë këtu vij si person publik që përfaqësoj Konfederatën e Sindikatave dhe nuk përfaqësoj as minatorët e Bulqizës, as minatorët e Shqipërisë, as naftëtarët, por të gjithë së bashku, mësuesit, agronomët, policët, pylltarët, mjekët, infermierët e të gjithë. Nuk ishte vendi të ndalohej te minatorët, sepse tashmë ligji është në zbatim dhe jemi e vetmja sindikatë që e kemi kundërshtuar, por duhet të kemi parasysh që sindikatat nuk janë lëvizje çartiste, që djegin goma apo thyejnë xhama, ato janë institucione, të cilat ulen në tavolinë. Unë besoj se sa herë jam ulur në këtë tavolinë nuk i kam lënë gjë mangët as qeverisë, as parlamentit, as sindikatës dhe as vetes time. Këtë e vlerësojnë ata që më kanë zgjedhur, ata që më kanë mbështetur dhe ata që do të më mbështetin. Në kongresin e Konfederatës zonja ishte përfaqësuesja më e madhe e qeverisë dhe ne nuk kishim as Lulzim Bashën dhe as Edi Ramën, të cilin e kishte dikush tjetër. Kështu që ne do të vazhdojmë ta ruajmë identitetin e profesionistit punëtor dhe pavarësinë politike.

Për sa i përket akuzës për pronat, ju jeni deputet dhe keni të gjitha atributet, më shumë se kushdo tjetër, që t'i drejtoheni çdo strukture, qoftë prokurorisë, qoftë komisionit hetimor apo kujt, por unë ju garantoj publikisht që pronat e Konfederatës së Sindikatave të Shqipërisë administrohen tërësisht në përputhje me ligjin dhe sigurojmë 30% të buxhetit të KSSH-së.

Dy herë janë kontrolluar nga Kontrolli i Shtetit dhe nuk ka asnjë problem, ta kesh parasysh ti, Ben Blushi, *Top Channel* kushdo se si menaxhohet, përfshirë dhe Rim Spahiun...

Enver Roshi – Sot jemi për një qëllim tjetër, nuk dua që të devijojë diskutimi. Ju duhet të kërkonit një seancë dëgjimore më vonë me Komisionin Shëndetësisë, për të prezantuar punën tuaj dhe kërkesat që keni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Me thënë të drejtën, ne jemi në debat, por dialogu social i zhvilluar ndërmjet palëve është një nga çelësat e suksesit. Ajo që dua të them është sepse unë isha në atë takim apo në atë kongres në nivel administrate publike. Absolutisht që nuk jam në nivel politik. Personalisht, mund të jap një opinion që duhet ta jap, sepse realisht nuk kemi pse t'i fshehim gjerat. Në qoftë se ka pasur një inicim dhe ndikim për rritjen e pagës minimale, ka qenë sepse në dialogun social në këshillin e punës është ngritur shumë fuqishëm. Ju e dini shumë mirë që punëdhënësit nuk pranojnë ngritjen e pagës minimale. Në qoftë se ka pasur një indicie për mbrojtjen e të drejtave të punëmarrësve, është pikërisht, sepse është ngritur fuqishëm. Pavarësisht se ne mund të kemi kundërshtuar, duhet ta pranojmë opinionin ndryshe, lobimin dhe ngritjen e zërit, sepse të gjithë sot i dëgjojmë, mund të themi argumentet tona, por kjo nuk do të thotë se nuk i marrim mendimet apo se nuk janë shkruar të gjitha këtu. Të jeni shumë të bindur që i gjithë zëri i grupeve të interesit, në mënyrë të veçantë i konfederatës, ka sjellë shumë ndryshime. Në qoftë se nuk qan fëmija, nëna nuk i jep për të pirë. Janë bërë shumë dëgjesa nga komisioni parlamentar. Dua ta them këtu se shoqëria civile përpara dy javësh në Gjenevë, në rishikimin rajonal të "Platformës për veprim të Pekinit plus 25" ka thënë se parlamenti në Shqipëri konsulton çdo ligj, çdo projektbuxhet me grupet e interesit. Mund të ketë boshllëk në mes, por kjo është ngritur dhe është konsideruar si një vlerë e shtuar e politikbërjes dhe e qeverisjes së Shqipërisë. Kështu që ne jemi të hapur për të gjitha qëndrimet pro dhe kundër.

Në lidhje me ligjin e minatorit, përsëri ka ardhur për komente për rritjen e pagave. Përsëri ne jemi në diskutim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, sepse, natyrisht, mbrojmë të drejtat e të gjithë atyre që kanë nevojë. Përsëri konfederata ka dhënë qëndrimin e saj dhe kërkesën për ta rishikuar.

Enver Roshi – Faleminderit, zonja Merita!

Vazhdojmë diskutimin, se nuk kemi shumë kohë.

Dua t'ia jap fjalën një grupi prindëresh për fëmijët me aftësi ndryshe, të përfaqësuar nga Lirie Dina dhe Elenica Kotelli. Ku janë? Më duket se kanë ardhur nga Korça. Kanë ditë që e kanë kërkuar dhe, duke pasur edhe miratimin e komisionit, t'u japim vëmendje. Kanë bërë një

shkresë drejtuar komisionit tonë. Ne i kemi thirrur dhe kanë ardhur nga Korça. Të dëgjojmë mendimin e tyre.

Urdhëroni,!

Elenica Kotelli - Përshëndetje!

Jam Elenica Kotelli, vij nga Korça. Përfaqësoj një grup të madh prindëresh jo vetëm të qytetit tim, por edhe të qyteteve të Elbasanit, të Kukësit dhe të Tiranës, sidomos të fëmijëve të spektrit të autizmit.

Gjithashtu, jam prind i një djali 16-vjeçar me autizëm. Ne prej shumë vjetësh kemi kërkuar një financim nga ministria për hapjen e një kabineti dentar në institucionin publik shëndetësor spitalor, pasi kjo është një problematikë shumë e madhe për ne, duke filluar që nga analizat laboratorike deri te shërbimet dentare. Fëmijët me autizëm dhe personat e spektrit të autizmit nuk mund të qëndrojnë për të marrë analizat, për të shkuar te dentisti, pra për të kryer shërbimet e duhura, ekzaminimet e duhura, por është shumë e vështirë. Ne kemi kërkuar prej vjetësh në qytetin tonë. Me prefektin, që sot është deputet e kemi diskutuar dhe atëherë na u tha se mund të zgjidhet shumë thjesht me një marrëveshjeje ndërmjet institucioneve spitalore dhe shëndetit publik që të ketë një kabinet në spital, ku të ofrohen këto shërbime. Megjithatë, ja ka jemi sot. Kërkesa të vazhdueshme i kemi bërë edhe drejtorit të spitalit dhe, për dijeni, ministres së Shëndetësisë, Ogerta Manastirliu. Deri më sot nuk na ka ardhur ndonjë zgjidhje. Jo më larg se para 10 ditësh një prind yni është detyruar të marrë borxh dhe të vijë në një spital privat në Tiranë që të kryejë një anestezi prej 8 orësh me një kosto shumë të madhe prej 1200 lekë të vjetër. Plus peripecitë e tjera, sepse për të ardhur duhet shoqëruar nga dy familjarë, pra është shumë e vështirë. Kështu që ne kërkojmë që të krijohet një kënd në kirurgji në spital, ku t'i jepet leje dentistit, sepse dentisti nuk mund të hyjë në kirurgji për të kryer këto ekzaminime, qoftë mbushje të dhëmbit, por duhet bërë edhe anestezia, sepse pa anestezi nuk mund të kryhet, pra që të bëhet kjo anestezi duhet të kryhen disa analiza. Kjo është vështirësia. Kërkojmë që të trajnohen laborantët, të trajnohen infermierët dhe disa dentistë që ta ofrojnë këtë shërbim dhe të mos u thuhet prindërve që t'u drejtohen klinikave private ose jashtë Shqipërisë, sepse shteti ynë më vjen keq ta them na jep një pagesë shumë qesharake, prej 20 mijë lekësh të rinj në muaj për fëmijën dhe kujdestarin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Paga minimale për një person në Shqipëri është një 24 mijë lekë, kurse ne 2 persona në familje...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë nuk jam eksperte.

Ne nuk mund të mbijetojmë, jo më të jetojmë dhe t'u ofrojmë shërbime fëmijëve tanë. Domethënë, duhet të jepet një zgjidhje e shpejtë, sepse nuk është se po kërkojmë ndonjë gjë të madhe. Dentistët janë, të trajnohen, të trajnohen infermierët dhe laborantët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo të gjithë, mund të zgjedh ministria se çfarë mund të bëjë, por neve të na ofrohet shërbimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rritja e financimit të pagesës së aftësisë së kufizuar, sidomos e spektri i autizmit, që nuk përfiton asnjë gjë. Domethënë, shërbimet dhe kostot i ka shumë të larta në krahasim me atë që mund të përfitojë. Pra, nuk përfitojmë asnjë ulje dhe as subvencionime nga shteti për shërbime. Sidomos në Korçë nuk kemi asnjë logoterapist, asnjë ergoterapist. Domethënë, nuk na ofrohen shërbimet terapeutike të ndryshme, të cilat spektri i autizmit i ka shumë të nevojshme, në mënyrë që ata fëmijë, të cilët janë prekur në atë masë që mund të ecin dhe të vazhdojnë, të mos i bëhen barrë shtetit nesër, por të trajtohen sot që nesër ata të jenë pak a shumë të aftë për të vazhduar jetën e tyre. Shërbimet mjekësore, dentare, ushqime, veshmbathje, ilaçe, terapi, pajisje të veçanta që u duhen atyre në jetën e përditshme as që mund të bëhen me ato lekë që ne marrim.

Gjithashtu, e përmenda edhe pak më lart kërkojmë financim dhe hapjen e qendrave të kujdesit social, të cilat ofrojnë shërbime terapeutike, terapi zhvillimi, logopedi, fizioterapi, gjithashtu edhe mbështetje për personat me AK dhe familjarët e tyre që kujdesen për ta. Pra, të ngrihen shërbime të specializuara, sidomos për personat madhorë, sepse fëmijët tanë u rritën tani dhe janë mbi 16 vjeç. Për këtë kategori fëmijësh, nuk ofrohet absolutisht asnjë lloj shërbimi. Kështu që duhet të mendohet që nesër prindërit do të plaken, nuk do të jenë më. Ku do të shkojë kjo kategori fëmijësh? Pra, duhet të mendohet për qendra rezidenciale ose shtëpi që këta të rritur nesër të jenë të siguar dhe të kenë ku të jetojnë dhe të mbështeten. Ju nuk mund ta imagjinoni dot se si është të jetosh me një fëmijë me autizëm ose me një adoleshent me autizëm që nuk flet dhe që ka shumë stereotipe të ndryshme, pra është një ferr i vërtetë të jetosh dhe të mos kesh asnjë mundësi ekonomike që t'i përballosh, sepse nuk mund të të thotë se çfarë i dhemb, nuk mund të të thotë e çfarë do. Nuk mund të kërkosh asnjë shërbim, nuk mund të kesh një mbështetje psikologjike edhe si prind, sepse prindërit janë të detyruar të rrinë 24 orë në 24 orë me këtë fëmijë, të marrin 100 mijë lekëshin, por punë nuk mund të bëjnë dot. Mund ta imagjinoni vetë se si jetohet në atë familje dhe si i përballojnë të gjitha shpenzimet që kanë.

Gjithashtu, financimi nga buxheti i shtetit i sigurimeve shoqërore të ndihmës personal të personit me AK dhe njohja si periudhë pune, sepse kujdeset gjatë gjithë jetës dhe deri më sot. Kjo duhet të njihet, sepse ai qëndron 24 orë me atë fëmijë, nuk mund të punojë, por nesër, nëse do të arrijë të dalë në pension, sepse me të gjitha këto strese halle dhe mund të mos arrijë dhe ta lërë atë fëmijë rrugëve, nuk ka vite pune. Kështu që nuk mund të mbijetojë. Pra, kjo duhet të shikohet.

Së fundi, sepse ka edhe shumë e shumë të tjera që mund t'i diskutojmë në komisione të tjera: si financimi për ngritjen e qendrave komunitare ose rezidenciale që do të shërbejnë për pritjen dhe strehimin e personave me autizëm në moshë madhore, të vetmuar dhe pa familjarë. Në bashki ende nuk janë ngritur ende njësitë e vlerësimit të personave me aftësi të kufizuara. Domethënë, ende nuk ka ardhur njeri as të shtëpia ime, as të shtëpia e prindërve të tjerë për të pyetur në çfarë kushtesh jetojnë këta njerëz; çfarë nevojash kanë; çfarë shërbimesh u duhen dhe si do jetojmë? Domethënë, pak a shumë të gjithë i njohin këto gjëra si Iliri dhe Edlira. Më vjen keq që në Korçë nuk i kemi këto shërbime. Kemi shumë gjëra të mira, por për aftësinë e kufizuar, sidomos për autizmin, nuk kemi absolutisht asnjë gjë.

Enver Roshi – Urdhëroni!

Kotelli – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja Kotelli!

Në fakt, e marr fjalën para se t'ia japim zonjës Xhafaj për një përgjigje, sepse e kam ndjekur një problem tuajin, që nuk e thatë sot. Ju përmendët 5 pika, unë po shtoj të 6-in, që është transporti për fëmijët me aftësi të kufizuara, kur këta ndjekin shkolla speciale, shkollat publike, e kemi diskutuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju i jeni drejtuar këshillit bashkiak dhe kryetarit të Bashkisë Korçë. E lexova me vëmendje, me thënë të drejtën, ju përmendët të gjithë shtrirjen e shoqatës suaj në qytete të tjera të Shqipërisë. Në fakt, në të gjitha qytete ka fëmijë me aftësi të kufizuara, dhe besoj se kjo nuk mund të zgjidhet nëpërmjet një vendimmarrje të një këshilli bashkiak. Në Korçë, përfaqësoj zonën e Devollit. Ju e dini që edhe aty ka fëmijë. Duhet që secili këshill bashkiak apo secili kryetar bashkie të kishte një vendimmarrje, e cila patjetër që nuk do të ishte e unifikuar me të gjitha të tjerat. Ndërkohë, problemi juaj është i njëjte për të gjithë.

E kam diskutuar nëse do të duhej t'i drejtoheshim Ministrisë së Mbrojtjes Sociale apo Ministrisë së Arsimit për transportin në shkollë, sepse është kjo e fundit që ofron rimbursimin për transport për fëmijët me aftësi normale, në bazë të distancave.

Në rastin tuaj nuk e di nëse duhej të ishte kjo ministria përgjegjëse. Për këtë arsye e kam ngritur problemin tuaj në seancën dëgjimore për buxhetin e vitit 2020 me ministren e Financave. Nuk morëm dot një përgjigje (patjetër ministria ishte e papërgatitur për këtë çështje dhe në padijeni), se zëvendësministria që na ktheu përgjigje, pasi ministria ishte larguar, na premtoi se do ta shikojmë, do bëjnë vlerësimin e nevojshëm dhe do të na japë një përgjigje, kur të vijë herën tjetër për të miratuar buxhetin.

Kjo pikë kërkon një vendimmarrje dhe një zgjidhje unike për fëmijët në të gjithë Shqipërinë.

Enver Roshi – Urdhëroni!

Lirije Dina – Jam përfaqësuese e Qendrës për Arsim Cilësor. Nuk përfaqësoj grupin e prindërve, por përfaqësoj një organizatë, e cila trajton problemet që lidhen me arsimin. Çështjen e transportit të fëmijëve me aftësi të kufizuara ne e kemi trajtuar jo vetëm në bashki të caktuara, por edhe në Ministrinë e Arsimit, e cila na është shprehur se kjo është kompetencë e vetë bashkisë dhe ministria nuk mundet t'i mundet t'i mbulojë shpenzimet e transportit për këta fëmijë.

Normalisht, ne bashkohemi me mendimin tuaj. Do të donim të kishte një zgjidhje unike për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe të gjithë fëmijët me aftësi ndryshe që ndjekin shkollën, të paktën, t'u sigurohet transporti si të gjithë bashkëmoshatarëve të tyre.

Faleminderit!

Enver Roshi – Urdhëroni!

Adelina Rista – Kam një koment të shkurtër. Unë ju falënderoj, zonjë, si përfaqësuese e një shoqate prindërore, që sillni këtu shqetësimet për fëmijët me aftësi të kufizuara. Si një prind që ndeshet përditë me këto shqetësime, prekni nga afër problematikën e kësaj kategorie.

Dihet se politikat sociale janë në themel të programeve qeverisëse dhe ne si parlament kemi miratuar shumë ligje dhe shumë paketa sociale në ndihmë të shtresave në nevojë, po kështu edhe për këtë kategori, për personat me aftësi të kufizuara.

Në një prej seancave të shumta që kemi pasur këtu në komision, unë personalisht, kur ka qenë diskutimi i projektligjit të caktuar për ndihmën sociale, kam ngritur një shqetësim, një shqetësim që të çon në shfrytëzim, që të çon në diskriminim të personave me aftësi të kufizuara. Kuotat përcaktohen nga fuqia ekonomike që ka një shtet. Shteti paguan një kujdestar për t'u kujdesur për personin me aftësi të kufizuara në familje. Është zgjedhja e familjarit që ky kujdestar do të jetë një person i punësuar jashtë familjes, i cili do ta marrë këtë pagesë për kujdestari apo do ta marrë personi i familjes.

Kjo është zgjedhje dhe ju keni zgjedhur që të kujdeseni vetë për fëmijën tuaj (po ju drejtohem juve), prandaj doja të dija mendimin tuaj si prind.

E thashë që në fillim që kjo lidhet me shfrytëzimin dhe diskriminimin e disa personave me aftësi të kufizuara nga vetë kujdestarët, nga vetë ata që marrin nga shteti pagesën për t'u kujdesur për këtë kategori. Po të shkojmë tani rrugëve të Tiranës, do të shikojmë mes makinave njerëz që nuk janë të aftë të dalin vetë për të lypur, por i nxjerrin familjarët, i nxjerrin ata kujdestarë që marrin paratë për t'u kujdesur për ta.

(Diskutime pa mikrofon)

Enver Roshi – Mos na devijoni diskutimin, ju lutem!

(Diskutime pa mikrofon)

Adelina Rista - Unë dua të përfundoj diskutimin tim. Është e drejta ime.

(Ndërpritet incizimi)

Adelina Rista – Kur kishim këtu ministren e Shëndetësisë, unë kam ngritur një shqetësim për problemin e qendrës me aftësi të kufizuara në qytetin e Fierit.

Në aneksin nr.4, në transferta specifike, disa qendra janë financuar nga qeveria për qendrat për personat me aftësi të kufizuara, si Kuçova apo Kukësi, ndërsa qendra e Fierit nuk është financuar. Është një qendër që rritet, se nga 30 persona ka vajtur në 60 e pastaj në 90 persona. Kjo është qendër që mbulon jo vetëm fëmijët me aftësi të kufizuara të qytetit të Fierit, por edhe nga bashkitë fqinje, Patoz dhe Roskovec.

Kjo qendër kërkon mbështetje financiare edhe për këtë qendër. E kam ngritur këtë problem.

Shqetësimi i dytë që unë ngre si qytetare e RSH-së, si prind, si gjyshe, si nënë, si arsimtare dhe si deputete e këtij Kuvendi, është shqetësimi për personat me aftësi të kufizuara.

E thashë edhe pak më parë se shteti financon sipas fuqisë ekonomike që ka dhe ne këtu kemi miratuar disa projektligje. Unë jam deputete që nga viti 2013 dhe shumë projektligje kanë kaluar në këtë komision pikërisht për nxitjen e punësimit, që ndikon edhe te personat me aftësi të kufizuara etj., etj.

Tashmë unë e ngre këtë shqetësim dhe do ta ngre gjithmonë. Mua më shqetëson fakti se të gjithë personat me aftësi të kufizuara, të gjithë ata invalidë që nuk janë të aftë të dalin vetë në rrugë se nuk i kanë mundësitë fizike, i nxjerrin të tjerët në rrugë për t'i shfrytëzuar. Unë këtë e quaj diskriminim.

Sot ne jemi mbledhur për buxhetin dhe kërkohet ngritje page për personat kujdestarë, të cilët kanë përgjegjësi, se u është besuar një person me aftësi të kufizuara, por këta persona

kujdestarë abuzojnë duke i nxjerrë këto persona me aftësi të kufizuar në mes të makinave duke lypur dhe unë këtë e quaj diskriminim.

Çfarë duhet të bëjmë ne, meqenëse ne miratojmë buxhete dhe kërkojmë që këtyre kujdestarëve t'u quhen vite pune vitet që kujdesen për këto persona me aftësi të kufizuara?

A duhet t'ua quajmë vite pune këtyre personave?

Unë kam një propozim direkt. Shteti që i paguan këta persona duhet të ngrejë një task-forcë për të gjithë ata që nuk kujdesen, por i shfrytëzojnë dhe i diskriminojnë, dhe kjo task-forcë të ketë tagrin që t'ua heqë kujdestarinë këtyre dhe këtë kujdestari ta marrë dikush tjetër që është i aftë dhe kujdeset.

Faleminderit!

Enver Roshi – Urdhëroni!

Merita Xhafa - Faleminderit!

E kam propozimin tuaj për qendrën “Horizont” dhe ju duhet ta dini, se ju e keni marrë përgjigjen dhe nuk ishte vendi këtu për ta sqaruar më tej.

Janë një sërë qendrash të shërbimeve sociale që në ligjin e buxhetit kalojnë direkt nga Ministria e Financave. Është qendra “Lira” në Berat, është qendra “Balash” në Elbasan, është qendra “Shpresa” në Shkodër, është “*Opera della Maddona della Grata*” në Shkodër, “Besa” në Vau i Dejës, si dhe qendra ditore të fëmijëve me aftësi të kufizuar për bashkitë Kuçovë dhe Kukës, të cilat pa dijeninë, pa kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë, por për shkak të lobimit të bashkive kalojnë direkt nga Ministria e Financës në financimin e bashkive. Kjo për ato qendra që janë ngritur me financim të huaj.

Për qendra “Horizont” mund të llojë bashkia për t'u financuar direkt nga Ministria e Financës, sepse kanë financime të huaja.

(Diskutime pa mikrofon)

Ju i keni miratuar ligjet dhe keni kërkuar të jenë detyrim i bashkive, ashtu si edhe fondi social.

Lidhur me shqetësimet që ngre zonja, unë e kuptoj shumë mirë se nuk është vetëm kjo zonjë këtu, por ka edhe shumë të tjera që kanë të njëjtat probleme.

Këto kanë qenë probleme të ngritura nga grupime të prindërve të fëmijëve me aftësi të kufizuar, të cilët janë detyruar të ngrenë shërbime për këta fëmijë.

Ngritjen e kabineteve dentare nëpër spitale ne do ta shikojmë rast pas rasti, sepse kjo nuk mund të bëhet në total, në drejtim të ngritjes së kapaciteteve, trajnimit të stafit, por edhe në drejtim të mbulimit me shërbim dhe ngritjen e kabineteve dentare.

Lidhur me pjesën e pagesave, reforma e re e aftësisë së kufizuar, e cila bën vlerësimin biopsikosocial, natyrisht, ka në fokus sipas grupmoshave fëmijët me aftësi të kufizuar. Për shërbimin me logoterapi. Ajo që më bën përshtypje nga 14 bashki që kanë aplikuar për fond social tek ne 10 kanë shërbimin për fëmijët me aftësi të kufizuara në familje. Kanë lidhur kontrata bashkitë me *World Vision* dhe po ngremë shërbimin e specializuar për fizioterapinë e fëmijëve në shtëpi. Politikat sociale janë të orientuara jo vetëm drejt decentralizimit, por edhe drejt deinstitutionalizimit të fëmijëve. Deinstitutionalizimi i fëmijëve, futja në qendrat rezidenciale ka krijuar probleme të tjera, të cilat janë shumë delikate dhe në të gjitha politikat globale është edhe deinstitutionalizimi. Është për këtë arsye që një nga angazhimet që kemi publikuar dhe në OKB me rastin e 30- vjetorit të Konventës për Mbrojtjen e Fëmijëve ishte pikërisht marrja e angazhimit për deinstitutionalizim të fëmijëve nga 0-6 vjeç. Kjo na rrit përgjegjësinë për të ngritur shërbime në familje. Unë do të inkurajoja jo vetëm pjesën e bashkëpunimit me bashkitë për të aplikuar për fondin social për këtë qëllim, por edhe pjesën e mundësisë së ngritjes si ndërmarrje sociale. Marrja e statusit për një organizatë që ofron shërbime të specializuara do të ofrojë më pas edhe në 3 vjetët e ardhshëm financimin nga buxheti i shtetit të kësaj strukture. Këto që janë probleme sot, janë ato problematika që ne kemi në fokus për t'i zgjidhur për të ardhmen.

Pjesa e transportit në bazë të ligjit “Për asistencën sociale” është detyrim i bashkive, por duhet të kemi parasysh edhe një gjë tjetër. Qeveria shqiptare ka marrë një nismë (pasi nuk është e lidhur vetëm me mbrojtjen sociale, por edhe me përfshirjen sociale) dhe i ka konsideruar vitet 2019 dhe 2020 vitet e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara. Ne bashkë me ekspertët përkatës kemi filluar të bëjmë një plan të aksesueshmërisë ku të reflektohen të gjitha nevojat e bashkive. Ky plan është në drejtim të futje së gjuhës së shenjave për ata që nuk flasin dhe nuk dëgjojnë, në drejtim të ofrimit të shërbimeve apo të aksesit për ata që janë persona me autizëm apo në drejtim të infrastrukturës. Nuk jemi vetëm, por janë edhe Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Financave. Shumë shpejt grupi i ngritur me urdhër të Kryeministrit do të paraqesë planin për miratim në qeveri. Të gjitha shqetësimet e ngritura nga zonja, por edhe më parë nga prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuar janë në fokus. Unë i kam shkruar të gjitha, sikurse i shikoni dhe do të jenë pjesë e këtij plani.

Enver Roshi - Faleminderit, zonja Merita!

Nevojat për këtë grup, sidomos për fëmijët autikë janë gjithmonë të mëdha, kërkesat janë shumë të ligjshme. Ju inkurajoj në emër të kolegëve të Komisionit për Shëndetësinë që të punoni për zgjidhjen e disa problematikave, që këto të quhen sigurime shoqërore, t'u njihet pensioni, pagesa për transport, për qendrat komunitare për ata që kalojnë moshën dhe mbeten

vetëm pa prindër. Paketa e shërbimeve është gjithmonë në rritje, por kërkon edhe një ndihmesë të veçantë, apo një përqendrim të veçantë nga ministria juaj.

Ju falënderoj për përgjigjet!

Fjalën e ka Ndrekë Ismaili, Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Tetraplegjikëve.

Ndrekë Ismaili – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë ju konsideroj miq në kuptimin e mirë të fjalës, pasi barra juaj është shumë e rëndë. Këtu të gjithë vijnë për të gjetur mbështetje nga ju.

Unë jam student i Dhjetorit dhe demokracia është gjë e mirë. Në demokraci institucionet duhet të kontrollojnë njëra-tjetrën. Nuk kemi pse të bëjmë një listë dhe t’ia lëmë barrën këtij apo atij institucioni. Institucionet drejtohen nga një kupolë lart, kontrollohen nga ju dhe gjërat duhet të rrjedhin lirshëm.

Shqetësimet që kam do t’i them me një fjali. Pastaj do t’i zbërthej pak më imtësisht. Nga ju dua të më ndihmoni që të jem i paraqitshëm dhe të shkoj ku të kem nevojë për të zgjidhur këto halle. Kjo është fjalia që ju duhet ta ngulitni këtu, në këtë mbledhje. Inshallah nuk ka nevojë që të vij vitin tjetër, por siç jua kam lënë vjet, do t’jua lë edhe një vit tjetër rezervë që të mos bëj debat. Pse duhet të jem i paraqitshëm? Ju të gjithë këtu, u ngritët nga një herë në këmbë dhe u çlodhët, po qëndruat 1 orë do të thoni: “U mpiva, të ngrihem përsëri”. Unë jam 8 orë në karrocë. A e imagjinoni kur shkoj në shtëpi? Shumica e kolegëve të mi, mos t’ju vijë habi, por më ka ndodhur t’i shikoj me sytë e mi që i fusin në varr me kapak të arkivolit të hapur, ose ua thyejnë kyçet. Pra, më ndihmoni të jem i paraqitshëm me një gjë shumë estetike.

Dje zoti Saimir tha nuk të ktheva përgjigje, sepse nëse ngremë një qendër rehabilitimi, nuk kemi specialistë. A mund ta lëmë një shërbim, kur kemi një universitet fizioterapie, kemi shumë fizioterapistë që vënë letra nëpër shtylla: “Ofrojmë fizioterapi në shtëpi”?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Qendra rehabilitimi.

Kur këta kanë 2 vjet që e kanë premtuar dhe nuk e kanë futur në lojë. Asnjë lekë nuk kanë hedhur për këtë gjë. Keni pasur për ta mbyllur në vitin 2020, por nuk keni hedhur as 100 lekë.

Unë nuk mund të ecë në këmbë, duhet të ecë me karrocë. Si të shkoj?

Akresi në infrastrukturë dhe transporti publik. Më duhet të ma zgjidhni këtë hall që të shkoj atje ku duhet që të zgjidh problemet. Është zgjidhur për sy dhe faqe në Tiranë, në Ministrinë e Shëndetësisë dhe të Mirëqenies Sociale. E keni parasysh, 3 herë kam ikur nga ajo ministri, më kanë hequr nga puna si i majtë, kur ishte PD-ja në pushtet, tani jam i djathtë kur

është PS-ja në pushtet. Bëhen lojëra, llafe si me qenë arixhofkat në rrugë, nuk dua t'i ofendoj ato. 3 herë isha përshtatur, por vetëm e kanë prishur aksesin e rampës, nga 10-12 % që ishte e kanë bërë 20%, ashensorin e kanë bërë 1 me 1 që nuk ka njeri të hipë me karrocë në të...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ngrihet edhe në këmbë, ecën edhe 2-3 hapa.

Transporti publik, a e shikoni se çfarë ka bërë kryetari i Bashkisë së Tiranës? Më ka thënë: “T’i mos hip në stacion”. I ka kufizuar në të dyja krahët. Nuk i ka trajnuar në mënyrë kategorike as shoferët e transportit publik, as faturinot për të ofruar aksesin. Kur i them faturinos: “Ule rampën në trotuar!”, më përgjigjet: “Nuk hapet, nuk punon!”, me neveri.

Ministria për Shëndetësinë dhe Mirëqenien Sociale vitin 2019 e shpalli vitin e aksesin, por 100 lekë nuk kanë hedhur për këtë gjë. Me çfarë do të bëhet ky akses? Unë për të shkuar të marr pensionin duhet të hip 4 shkallë, sepse kanë marrë me qira hyrjen e pallatit të Sadri Abazit dhe na e kanë çuar pagesën atje. Fitoi Posta Shqiptare sh.a, e vjedhin aftësinë e kufizuar 19 milionë lekë të vjetër në muaj, na e vjedhin ne dhe ia japin postës sh.a. Kush është pronari i postës sh.a? Sa bëhen në vit? A nuk ishin përshtatur këto institucione me këto lekë?

Miq të mi, shikoni me kujdes, se nuk po ju kërkojmë para, luks. Kanë hapur buxhetin e shtetit dhe të gjitha institucionet kërkojnë kompjuterë, vit për vit, 20 vjet rresht Ndrekë Ismailit nuk i ka blerë njeri karrocë, e kam me ligj. Në nenin 16 thuhet: “1 herë në 3 vjet paraplegjikut i jepet karrocë”. Kurrë nuk ma kanë dhënë karrocën. Me çfarë duhet të shkoj te sigurimet shoqërore? Me çfarë duhet të shkoj të përballem me ministrin dhe të zgjidh hallin tim? Po, nuk ka buxhet!

Hiqni qiratë një nga një, se po nuk filluam t’i heqim një nga një, atëherë do të prisni të vijë thesi i lekëve nga bota dhe kështu do ta zgjidhni? Nuk zgjidhet kështu. Të gjitha institucionet duan restaurim. Pse?! Mos t’ju vijë keq, ta themi hapur, drejtorët e institucioneve vjedhin 15% të buxhetit. Fusin tenderë. Nuk janë bërë kot bosë disa njerëz aty. Unë kam veshur triko pambuku dhe e kam blerë te “Gabi”. Karrocë nuk më jep njeri, shërbim jo, rehabilitim fizik jo, mundësi për t’u arsimuar jo. Kam mbaruar shkollën në kohën e Enverit për fizikë. Kam shkuar të bëj fakultet të dytë se e pashë që Europa po hedh sytë nga ekologjia dhe thashë po vazhdoj për mjedisin në Institutin Bujqësor Unë e di sesa kam vuajtur, 3 vetë duke më hipur nëpër shkallët e institutit dhe nuk pranonin të bënin një rampë: “Prishet struktura e universitetit”. Edhe ju ndoshta thoni: “Mjaft se na lodhe!”.

Enver Roshi - Jo, nuk shprehemi kurrë kështu.

Ndrekë Ismaili - Nëse ju, miqt e mi, nuk e konsideroni hallin tim si hallin tuaj, nuk keni për t'i zgjidhur kurrë hallet tona.

Unë nuk e di se cila është ajo femër, qoftë “Nënë Tereza”, që të vijë dhe të më shërbejë mua 24 orë si një fëmijë i sapolindur për 160 mijë lekë në muaj. Ma thoni!

Zonja deputete e Fierit, Artur Lipe në Patos ka vdekur i vetëm. Ai më ka marrë 30 herë në telefon: më gjej një shtëpi me qira dhe një person që të më shërbejë, se me 100 mijë lekë nuk më shërben njeri. As me 200 në Fier nuk shkon njeri. Se nuk ka njeri kohë të lërë punën e tij për 100 mijë lekëshin tim. Kujdestari i fëmijës nuk ri nga qejfi, jo. Nuk i vjen njeri me atë pagesë dhe më mirë sakrifikon veten, se as i bën punën fëmijës dhe as bën punën e vet.

Më konsideroni mik.

Faleminderit!

Enver Roshi - Të falënderoj për fjalët me shpirt që thatë! Janë me të vërtetë fjalë që prekin dhe ju i keni në vuajtjen e përditshme, por njëkohësisht ne jemi shumë të ndjeshëm ndaj problematikës suaj.

Ndrekë Ismaili - Ju lutem edhe një fjali kam. Sinani pati një hall pak më parë, e ka më tepër hall personal sesa për personat. Ai iu drejtua ministrisë për ata që kanë fituar gjyqin. Ministria e ka pranuar mediatikisht dhe në konferencën që kanë bërë. U kanë para dhe tetraplegjikëve dhe kujdestarëve 2 milionë lekë të vjetër borxh. Kemi filluar me gjyqet. Nëse ju na detyroni që të vazhdojmë me gjyqet, ne 6800 paraplegjikë do të bëjmë 2 gjyqe: edhe në Gjykatën Administrative, edhe në atë të Apelit. Do të shkojnë rreth 13 mijë e ca gjyqe. Juve do t'ju shtohet minimumi 30 % borxhi, sepse ne do të marrim një avokat. Avokati minimumi do të marrë 700 mijë lekë dhe për 2 milionë që keni borxh, do t'ju shtohet 30% në buxhet. Nuk kemi hall që ta lani sot, por, në mos sot, do ta lani nesër. Mos iu lini topin njëri-tjetrit. Ky komision duhet të ndërhyrë urgjentisht. Hajdeni ta zgjidhim! A ua shtojmë pagesën këtyre njerëzve muaj për muaj që të mos rëndojmë buxhetin, apo do t'jua japim si dëmshpërblim gjobe 1 herë në 2 vjet? Si do të zgjidhet?! Ky është i gjithë problemi, por të mos ia lëmë topin bashkisë, kësaj ministrie.

Unë e kam fituar aty gjyqin me ju, dhe deri më tani i kam marrë 78 milionë tek ju, e do të marr deri sa të dal në pension, në qoftë se ju nuk reagoni. Ose reagoni, që të zgjidhim hallet e popullit, ose, nëse rrini kështu, ne mbaruam.

Enver Roshi – Faleminderit, Ndrek!

Po, Merita.

Merita Xhafaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Arsyeja se përse e keni fituar ju gjyqin dhe se çfarë po merrni, nuk ka fare lidhje me indeksimin.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem! Nuk ka lidhje fare me indeksimin, por ka lidhje me vendimin e gjyqit, sa u takon shkaqeve për të cilat ju jeni larguar nga puna. Nuk mund të flas për këtë, sepse nuk kam qenë fare pjesë e këtij procesi.

Edhe pjesa e indeksimit nuk i takon vitit 2013 e këtij. Pjesa e indeksimit, për të qenë të sinqertë, sepse duhet t'i shtrojmë problemet, duhet ta shprehim qartë se cilës periudhë i ka takuar. Edhe po të dua unë, edhe po të dojë ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të kërkojë dhe të ndjekë likuidimin e kësaj vlere të prapambetur, kjo lloj fature ligjërish, juridikisht, sipas vendimit të gjykatës, nuk i takon Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por pushtetit vendor. Në qoftë se pushteti vendor nuk ka fonde, është i detyruar të negociojë e të kërkojë nga Ministria e Financave.

Unë jua thashë, dhe ua them prapë: asnjë nga bashkitë nuk ka kërkuar fonde të dedikuara për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale në programin specifik që ata kanë. Kërkesën e kanë zero, dhe këtë konfirmim e kam marrë nga Drejtoria e Buxhetit në Ministrinë e Financave.

Lidhur me aksesueshmërinë, keni shumë të drejtë. Problemet e ngritura nga zoti Ndreka, qoftë mbulimi i transportit, qoftë problematikat kanë të bëjnë me aksesueshmërinë. Unë e thashë pak më parë: është duke u punuar plani, i cili do të kalojë e do të miratohet në qeveri.

A bëhen dhe a realizohen dot të gjitha? Natyrisht, ne nuk kemi pse të jemi entuziastë deri në atë masë sa s'mund ta përballojmë financiarisht, por sikur edhe 50 % e atij plani të realizohet, unë besoj dhe mendoj se është sukses. Nëse realizon 50 % të një plani, natyrisht që s'është e kollajshme, është shumë e vështirë. Ka nevojë për fonde, për buxhete e të tjera.

Në këtë kontekst, ne jemi të angazhuar për t'i realizuar një nga një të gjitha kërkesat e paraqitura.

Klodiana Spahiu – Faleminderit, kryetar!

Në fakt, ndjehemi pak keq, sigurisht, të gjithë deputetët këtu, edhe përfaqësuesit e ministrisë, pas të gjitha ankesave që pasqyroi Ndreka. Në fakt, nuk i pasqyron vetëm, Ndreka, sepse këtu është i gjithë grupi që përfaqëson Ndreka.

Unë mendoj, Ndreka, se ndoshta ka ardhur momenti që të jemi pak më konkret, pra me kërkesa më konkrete. Është e drejtë që keni të prapambetur indeksimin e vitit 2005, 2010. Ka plot gjëra. Ne duhej të dilnim nga kjo seancë dëgjimore me dy objektiva, që të paktën t'i realizojmë. Është e drejtë ajo që thoni ju. Vjet nuk keni ardhur, por mbaj mend se parvjet kanë qenë një pjesë e këtyre. Janë të njëjtat. Këtë pjesën që ndodh me transportin publik nuk e

zgjidhim dot ne këtu. Është shoqata e bashkive. Në si komision mund të kërkojmë për një seancë dëgjimore shoqatën e bashkive, për t'u thënë: shikoni, kjo punë duhet zgjidhur, sepse është diçka e vogël, e cila nuk kërkon shumë buxhet, por e lehtëson shumë jetën tuaj.

Në lidhje me atë, që ju e quani person shoqëruar, e që ka atë pagë minimale, është e vërtetë se mund të mos mjaftojnë 100 mijë lekë, Ndrekë, por nuk duhet të harrojmë se sot, edhe me plakjen e popullsisë, ka plot pensionistë që jetojnë vetëm, janë në shtrat dhe nuk kanë person shoqëruar. Prandaj, duhet të jemi pak më gjithëpërfshirës në problematika.

Merita tha se ne po bëjmë planin e veprimit për moshën e tretë, dhe unë i përgëzoj. Në fakt, ne duhet të punonim edhe për një status të veçantë për moshën e tretë, sepse ka shumë kohë që e kanë kërkuar.

Tashti, kur vjen halli te prindërit tanë, që mbeten në shtrat dhe ne nuk kemi me kë t'i lëmë, e kuptojmë çfarë do të thotë që një njeri të mbetet në shtrat dhe të kërkojë një person që të mund t'i shërbejë, qoftë edhe për nevojat minimale.

Unë do ta shikoja pak më gjerë problemin. Për ju pa diskutim, por edhe për ata persona të cilët, për shkak të sëmundshmërisë në stadi të avancuar, mbeten në shtrat.

Ministria ka filluar vlerësimin biopsikosocial, dhe unë uroj dhe shpresoj shumë që ky kontigjent që sot është në shtrat ose për shkak të aksidenteve ose për shkak të sëmundjeve të lindura, të kenë një mundësi pas komisionimit, qoftë edhe me këtë vlerë, të cilën ju e konsideroni minimale. Ka ardhur momenti kur ne nuk mund të komisionojmë më vetëm njerëz tetraplegjikë. Unë e kuptoj se gjithçka përkthehet në para, ndaj kur vjen fjala te buxheti, të gjithë tregohemi shumë të kujdesshëm. Me çfarë kemi parë ne, Ndrekë, buxheti që vjen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Çështjeve Sociale, kemi parë që kanë tentuar të mbulojnë problemet kryesore. Padyshim, ju e dëgjuat edhe dje. E patë në shoqatat e pacientëve se sa është shtuar sëmundshmëria, sa shtohet çdo vit, dhe bashkë me to sa shtohen komplikacione. Në fund të fundit, çdo komplikacione i sëmundjes përkthehet në shtim buxheti.

Prandaj, unë do të kërkoja nga ju një lloj bashkëpunimi. Të mos presim vetëm këtë seancën dëgjimore të buxhetit, se nuk e zgjidhim dot kështu. Sot me të vërtetë u bëmë keq të gjithë, sepse fjala jote është me të vërtetë shumë e rëndë për secilin nga ne. Mos kujto se ne jemi të pandjeshëm, por këto janë mundësitë.

Kështu, besoj se në lidhje me gjërat për të cilat duhet përgjegjshmëria njerëzore në detyrë, duhet të jemi më këmbëngulës. Pra, jo ta përkthejmë çdo gjë vetëm te buxheti, te mundësia dhe tek ajo që thoni ju, se edhe restaurimet do të bëhen, sepse janë bërë gjithmonë. Nuk është çështja se po i bën qeveria tani. Restaurimet përbëjnë një pikë të veçantë e buxhetit.

Më fal, kryetar, se e zgjata! Ne jemi të hapur si komision, Ju mund të na i dërgoni një nga një ato që mund të bëjmë ne. Sepse, kur nuk realizohet në Tiranë çështja me transportin publik, mendoni ç' mund të ndodhë në një qytet tjetër, ku transporti publik mund të jetë akoma më i vështirë.

Ju falënderoj!

Enver Roshi – Ju lutem, le të jemi më konkretë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Merita Xhafaj – Jo, ashensori është vetëm për ata që vijnë nga institucionet, jo për të tjerët që janë me...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më falni! Kjo çështje, dhe arsyeja se përse kemi kërkuar që ky të jetë viti i aksesueshmërisë, e dini pse është? të gjitha institucionet, edhe ministritë, të cilat janë rikonstruktuar, nuk kanë bërë aksesueshmëri. Bardhylka Kospiri i ka detyruar punonjësit, që ta ngrenë hopa në krahë, me gjithë karrocë, për ta ngjitur deri në katin e katërt, që ta kuptojnë çfarë gabimi kanë bërë. këtu nuk ka fare vëmendje, në qoftë se në ligjin për lejet e ndërtimit, nuk vendoset kusht që ministria jonë të japë lejen dhe vlerësimin e projektit, që ka brenda një ram. Se nuk u kushton gjë të bëjnë një ashensor e një ram.

Në qoftë se kërkojnë lejen mjedisore, nuk e vënë detyrim që KRRT-ja e çdo bashkie të miratojë një projekt vetëm pasi të jetë miratuar nga ministria jonë, në lidhje me elementët e aksesueshmërisë. Mora vetëm një element, sepse të tjerët janë...

Enver Roshi – Shumë e drejtë. Është një fenomen, të cilin e hasim përditë. Habitemi se si këta ndërtues, që bëjnë pallate me dhjetëra kate, nuk arrijnë të bëjnë një tramp aty. Edhe kur e bëjnë, e bëjnë ose të pjerrët, që rrezik të thyesh kokën, ose të rrëshqitshme, ose të ngushtë.

Unë i propozoj komisionit, që në një seancë të ardhshme të thërrasim kryetarin e shoqatës së bashkive, për të parë më nga afër problematikën në lidhje me transportin, por edhe në lidhje me ndërtimet që bëhen.

Fjala për juve, Abdulla!

Abdulla Omuri – Faleminderit, zoti kryetar!

Unë do flas shumë shkurt. Ashtu si katër vjet më parë, unë kam kërkuar dhe kam alternuar edhe me Ministrinë e Financave, për të ndihmuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Kërkohet një shtim prej 73 mijë e 600 invalidësh të punës. Ne jemi tepër të organizuar, jemi një institucion, por natyrisht nuk mund të sjellim 61 degë tona këtu. janë invalidë pune, të cilët janë aksidentuar në punë, janë me sëmundje profesionale. Janë të gjithë me kontribut, dhe sot, nga 7800 të reja, marrin deri në 1670 lekë.

Pas premtimit të Kryeministrit, në vitin 2014, pritëm dy vjet, pastaj filluam ta kërkojmë. Zonja që kam përballë, më 2016-ën tha se janë planifikuar. Po sot, si mund të përgjigjet? Kësisoj, më mirë të heshtë. Me të drejtë i thashë: prapë ti ke ardhur? Janë tetëqind milionë, që kërkojmë.

Së dyti, Ministria e Financave...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po një mijë lekë për çdo kategori, për invalidë e punës te ndihma e paaftësisë. Sepse, kolegët tanë të kategorive tjera marrin trefishin e kësaj ndihme të paaftësisë.

Pra, në momentin kur mua më duhen dhjetë minuta për të lëvizur, kjo është ndihmë paaftësie që jepet në të gjithë botën. Ne nuk po kërkojmë sa kanë kërkuar kolegët tanë, nga ato që i kanë të prapambetura, ne po kërkojmë në mënyrë shumë modeste. Nuk bashkohen me fjalën e disa deputetëve, që thonë se ne bëhemi palë. Mua s' më bie ndërmend kjo. Unë kam kandiduar si i pavarur në 2009-ën dhe nuk më bie më ndërmend për politikën, me sa më ka lutur edhe politika mua për të shkuar atje.

Jam një invalid i aksidentuar në minierë, dhe nuk dua të merrem me politikë. Ata politikanët njoh që nga viti 1991, ata të parët, jo këta të rinjtë, dhe e di si janë.

Ia kam thënë edhe Komisionit të Ekonomisë, ndaj ju lutem edhe juve, zonja Spahiu, si një zonjë me përvojë të gjatë parlamentare, e kemi shprehur këto edhe në seancë dëgjimore: nëse këto nuk realizohen, ne do të ndjekim rrugët tona demokratike, por atëherë nuk del Abdullahi siç kam ardhur sot, me paterica, por do të dal me paterica, e kjo do të jetë shumë e dhimbshme. Sepse ka katër vjet që e kërkojmë këtë.

Së dyti, kërkoj mirëbesimin tuaj në seancë plenare. Na është vënë taksa e banesave në kundërshtim me ligjin, në kundërshtim me vendimin e vitit 2012 të Gjykatës Kushtetuese, në ligjin për buxhetin e kaluar. E kam kundërshtuar edhe vitin e kaluar. Një e drejtë e fituar nuk mund të hiqet. Nëse nuk duam të paguajmë taksa, më thoni ju mua: unë marr 87 mijë lekë të vjetra. Jam invalid i pjesshëm, me të drejtë pune. Edhe sekretari i përgjithshëm, pavarësisht se është me një dorë, ai merr po kaq. Me çfarë të paguajmë?

Çfarë do të bëj për katër-pesë të tjerët në shtëpi, me ato 87 mijë lekë të vjetra? Pra, ligji 7889, neni 16 na përjashton nga taksat? Ligji 9632 "Për taksat vendore", në bazë të udhëzimit 353. Po kështu, e ka hequr edhe Fatos Nano, me udhëzimin 212, kur ka qenë ministër Ben Blushi. Pra, invalidët e punës përjashtohen nga taksat vendore dhe nacionale.

Në lidhje me këto dy gjëra kërkoj ndihmën tuaj. Përndryshe, ne do të ndjekim rrugën tonë. Boll kemi duruar. Të punosh 12 vjet në nëntokë dhe të marrësh 78 mijë lekë! Pavarësisht

se ligji për minatorët ka filluar të zbatohet, të jemi të sigurtë. Deri tani kanë përfituar 173 vetë nga ligji për minatorët.

Pra, kërkojmë që të mos të diskriminohemi në këtë farë mase.

Unë ju falëndero për këtë seancë të lodhshme që patët mundësinë dhe burimin për të na dëgjuar. Realisht, jemi shumë të sjellshëm.

(Diskutime pa mikrofon)

Kam edhe diçka, zoti kryetar. Nga përvoja ime 28-vjeçare, mbaj mend, pasi para 2 vjetësh kam qenë në parlamentin irlandez, prandaj do t'ju lutesha, ju si deputetë të keni mirësinë të bëni diçka, referonte sekretari i Përgjithshëm i Irlandës, pasi deputetët atje çdo 3 muaj merrnin informacion nga shoqatat.

Nuk mund të bëheshin të gjitha brenda 1 dite, kjo është mëse e kuptueshme, dje folëm për shëndetësinë e të tjera me radhë.

Enver Roshi – Abdulla, propozimi jua është shumë i drejtë sa i takon marrjes së informacioneve nga shoqatat, por edhe ju vetë gjatë gjithë kohës mund të na vini në dijeni, duke na dërguar shkresa dhe informacione dhe në këtë mënyrë edhe ne do të kemi mundësi që herë pas here ta monitorojmë punën tuaj dhe të qeverisë. Disa nga këto informacione mund të jenë të strukturuar sa i takon numrit të invalidëve, shkallës së invaliditetit e shumë problematika të tjera.

Zonja Merita, ju lutem, shumë shkurt përgjigjet tuaja sa u takon kërkesave që ka Abdullahi në lidhje me ju!

(Diskutime pa mikrofon)

Abdulla Omeri – Zonja Merita, nuk e vlerësoi ndihmën e paaftësisë. Këtu ka një ngërç midis Ministrisë së Financave dhe asaj të Shëndetësisë, sepse në të thuhet që ndihma shkon për dy kategori të verbërit dhe aftësia e kufizuar indeksohen në shtator, pavarësisht profilit...

Enver Roshi - Merita ka shumë eksperiencë në këtë drejtim dhe i njeh mirë problematikat tuaja.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë jam i sigurt se po ta ketë në dorë Merita, do ta rregullojë këtë punë...

(Diskutime pa mikrofon)

Është drejtoreshë e politikave?

Merita Xhafaj – Unë nuk po nisem nga fyerjet personale...

Enver Roshi – Nuk ishte fyerje, por ishte diçka miqësore.

Merita Xhafaj – Ngërçi qëndron në ndarjen e invalidëve të punës, një pjesë e tyre i kalojnë Ministrisë së Financës dhe Ekonomisë, ndërsa pjesa tjetër te ministria ku unë jam pjesë...

(Diskutime pa mikrofon)

Këta janë kontingjent që trajtohen nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe nuk varen nga ne. Te ne marrin vetëm pjesën që thotë Abdullahi, pjesën e ndihmës ekonomike, e cila është parashikuar në projektbuxhet. Në ligjin për asistencën sociale u bënë disa ndryshime, ku u fut edhe kategoria e invalidëve të punës dhe është pikërisht kjo risi që keni sjellë ju, të cilën nuk e solla unë, për arsye se ngelëm bashkë ballë për ballë në momentin e seancës dëgjimore sa i takon ligjit për asistencën sociale.

Jam shumë e sigurt që Abdullahi është nga ata persona që të mirëkuptojnë dhe realisht të gjitha shqetësimet që ngre kanë nevojë për vëmendjen tonë si Ministri e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, por edhe për faktin që komisioni juaj duhet t'i drejtohet Komisionit të Ekonomisë dhe Financës për heqjen e taksës së banesave, e cila u është vendosur padrejtësisht kategorisë së invalidëve të punës. Unë mendoj se kjo çështje ka nevojë për vëmendjen tuaj dhe duhet ta trajtoni në Komisionin e Ekonomisë dhe Financës, sepse nuk është hera e parë që Abdullahi e ngre këtë çështje. Ajo që na takon ne si përfaqësues të Ministrisë së Shëndetësisë dhe të Mbrojtjes Sociale është fakti që duhet ta kemi në konsideratë në paketën e akteve nënligjore të ligjit për asistencën sociale, i cili do të kompletohet më pas, sepse kjo paketë është në përgatitje e sipër.

Abdulla Omuri – Unë jam dakord dhe për këtë falënderoj dikasterin dhe zonjën që e përfaqëson atë. Dua të theksoj që ne të gjithë kemi qenë pranishëm dhe kemi punuar me përfaqësuesit e ministrisë, sa i takon nenit 3 ligjit për asistencën sociale, besoj se ju kujtohet, janë përfshirë edhe invalidët e punës dhe kur i plotësojnë kriteret do të trajtohen në skemën e ndihmës ekonomike.

Sa i takon ndihmës së paaftësisë, e cila ka një buxhet më vete, i cili i shkon ose mendoj të trajtohet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, pasi invalidët e punës marrin pension nga sistemi i ligjit të sigurimeve shoqërore, të kalojë si një kolonë më vete dhe më pas këtë çështje e zgjidh me këta persona.

Unë jam një njeri i pjekur dhe prej 28 vjetësh dialogun e kam primar. Ju duhet të keni diçka parasysh, Meritën nuk e ofendova, pasi këtu është një 1 mijë lekësh, të cilin e ka premtuar Kryeministri dhe unë do të dal dhe do t'i them cilitdo prej deputetëve të maxhorancës se nuk është progres. Në të vërtetë në sistemin e drejtësisë është bërë progres, gjë që e thashë në mënyrë konfidenciale edhe në Gjenevë, por unë nuk dua të vdes, dua të jetoj.

Faleminderit!

Klodiana Spahiu – Nëse përfaqësuesit e ministrisë janë dakord që të hiqet pjesa e taksës, a mund të bëjmë një lobim? Ne si komision të gjitha sugjerimet që bëhen këtu ia dërgojmë Komisionit të Ekonomisë, por është shumë e vështirë që këto të bëhen. Pra, nëse të dy ministrisë bien dakord ndërmjet tyre atëherë të gjithë bashkë duhet të llobojmë dhe ta realizojmë.

Ilir Pendavinji – A është kjo në ligj? Ne duhet t'u kërkojmë që të zbatohet ligji dhe juve t'ju kërkojmë ndihmë. Për çfarë duhet t'u kërkojmë ndihmë? Unë mendoj që duhet të zbatohet ligji edhe në tabelat përkatëse të buxhetit, pasi nuk e di ku është pjesa që thotë Abdullahi. Zonja Xhafaj nuk ka se çfarë të bëjë...

(Diskutime pa mikrofon)

Abdulla Omuri – Zoti Ahmetaj, në telefon, konfidencialisht, më ka thënë se është bërë lapsus. Pra, janë parashtruar dy pensionistë, por nga logjika ekonomike kjo sjell më shumë të ardhura. Dua të di sjell nëse sjellin më shumë të ardhura një apo dy invalidë?

Po ashtu, ministrja është në dijeni, pasi në datën 29 në një takim që kam pasur me të gjatë muajit të kaluar i kam pasqyruar 4 gjëra, ku dy prej tyre i diskutuam sot, prandaj mendoj se duhet bërë një lobim.

Faleminderit!

Enver Roshi – Fjalën e ka Alketa, si përfaqësuese e UNICEF-it.

Alketa Zazo – Faleminderit, zoti kryetar!

Çështjet që unë kam do t'i përmbledh sa më shkurt. Ne si përfaqësues të UNICEF-it kemi qenë të pranishëm gjatë gjithë këtyre ditëve para jush dhe komisioneve të tjera, për të sjellë para jush besimin se investimet në buxhete të mira, transparente dhe efektive ndikojnë drejtpërsëdrejti tek të drejtat e fëmijëve. Dje dëgjuam përfaqësuesin e Ministrisë së Shëndetësisë, i cili me të drejtë u shpreh se kur ne bëjmë buxhete shikojmë shëndetin e ekonomisë, duke parë shëndetin e ekonomisë shohim edhe mundësitë buxhetore.

Si përfaqësues të UNICEF-it jemi koshientë, edhe nga llogaritjet që kemi bërë, që investimet që shkojnë në arsim, në shëndetësi dhe në mbrojtjen sociale, për të cilën jemi duke folur sot, zënë një përqindje të konsiderueshme jo vetëm të GDP-së, por edhe të buxhetit të qeverisë. Kjo është diçka që duhet përgëzuar, por nga ana tjetër të gjithë e dimë se jemi ende shumë larg standardeve ndërkombëtare, vendeve më të zhvilluara të Europës, ku me të drejtë aspirojmë të aderojmë.

Sa i takon buxhetit që shkon për mbrojtjen sociale dua t'ju them se për fat të mirë, që nga viti 2015 kemi një trend, sa i takon mbajtjes prej 3% të GDP-së, çdo vit kemi një rritje që

është në linjë me atë çka është parashikuar në PBA. Së bashku, nuk është se po i kërkojmë llogari ministrisë, por në të njëjtën kohë po e ndihmojmë që ajo të abdikojë, edhe pse kjo përqindje tashmë është e lartë përsëri nuk është e mjaftueshme. Mendoj se do të ishte mirë që Ministria e Financave ta shtonte përqindjen për të qenë sa më afër standardeve ndërkombëtare.

Buxheti i vitit 2020 tregon qartë që ka një rritje sa u takon pagesave në kesh, çka i dedikohet jo vetëm konsolidimit dhe ndihmës ekonomike, por edhe iniciativës së re të bonusit të bebeve, një iniciativë mjaft e mirë. Kjo nuk është vetëm për buxhetin e vitit 2020, por besoj se është edhe një reflektim, sugjerim dhe një ofertë për ndihmë nga ana jonë si UNICEF për të parë pak më mirë mundësinë se si të përdoren pagesat e ndihmës ekonomike duke marrë parasysh situatën e familjeve, harmonizimin e pagesës së ndihmës kesh me linja të tjera buxhetore, të cilat jodomsdoshmërisht vijnë nga Ministria e Mbrojtjes Sociale.

Siç e u shpreh pak më parë zonja Xhafaj, ministria po përpiqet të shohë më mirë edhe subvencionin për kompensimin e energjisë. Gjithashtu, ne e dimë që aktet nënligjore të ligjit për ndihmën ekonomike janë duke u bërë, prandaj shpresojmë që ka shumë mundësi të arrihet një harmonizim më i mirë i ndihmës ekonomike dhe shpresojmë se vitin që vjen do të kemi diçka më të mirë.

Sa i takon pjesës së shërbimeve sociale shohim me shumë kënaqësi se trendi që u vendos këtë vit, për vendosjen e parave nga buxheti i qendror për fondin social është në rritje, këtë viti është 150 milionë, vitin që vjen do të jetë 200 milionë dhe në vitin pasardhës do të jetë më në rritje. Vitin që vjen 14 bashki do të marrin para për të ngritur disa shërbimeve të reja që mungojnë, çka tregon se 200 milionë lekë që janë adresuar për vitin që vjen do të shkojnë për ngritjen e këtyre shërbimeve të reja. E di shumë mirë që ky është shqetësim nga ana e ministrisë, por edhe nga ana jonë njëkohësisht.

Gjithashtu, shohim se nga ana e bashkive ende nuk janë ngritur strukturat e duhura të burimeve njerëzore. Ligji për shërbimet sociale kërkon të ketë një punonjës social për 10 mijë banorë, ligji për mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve kërkon që të ketë një punonjës për mbrojtjen e fëmijëve për 3 mijë banorë, prandaj bashkitë duhet t'i vendosin këto...

(Diskutime pa mikrofon)

Ne shpresojmë, ndërkohë që bashkitë përpiqen për t'i kenë mbushur këto boshllëqe, duke u nisur nga ofertat e pakushtëzuara apo nga të ardhurat e tyre, të paktën që ministria nëpërmjet fondit social të parave që janë alokuar të fillojë të incentivojë nga në mënyrë që të ketë sa më pak boshllëqe.

Një tjetër propozim që kemi, besoj se kjo do të diskutohet dhe me ministrinë, jo për këtë vit, për të përmbushur disa nga shqetësimet që u ngritën nga grupet e interesit, sidomos të

personave apo të fëmijëve me aftësi ndryshe, lidhet me shërbimet e specializuara për fëmijët me paaftësi apo për mjetet ndihmëse. Ndoshta buxheti i mbrojtjes sociale nuk e ka fuqinë për ta mbuluar këtë pjesë, por një zgjidhje mund të jetë alternimi i buxheteve ndërmjet mbrojtjes sociale dhe fondit të sigurimeve shëndetësore. Kur flasim për shërbimet e specializuara, këtu futen edhe shërbimet shëndetësore, si dhe mjetet ndihmëse, prandaj mendoj që ky është një sugjerim që duhet parë.

Siç u shpreh edhe zonja Xhafaj, Ministria e Mbrojtjes Sociale ka shprehur me forcë angazhimin për deinstitutionalizimin e fëmijëve, duke pasur si fokus fëmijët 0-6 vjeç. Ndërkohë që fondet për këto shërbime rezidenciale janë të alokuara, apo edhe për fëmijët që birësohen, mendoj se ka vend për një mbështetje më të mirë të buxheteve që shkojnë për qendrat rezidenciale, ndërkohë që ato janë duke u transformuar dhe në këtë mënyrë shihet edhe familja kur fëmija del nga institucioni.

Këto janë pak a shumë mendimet dhe ofertat që ne kemi për t'ju ndihmuar në mënyrë që vit pas viti t'i zgjidhim të gjitha boshllëqet.

(Diskutime pa mikrofon)

Brikena Qirjazi– Alketa ka ardhur si përfaqësuese e UNICEF-it, por ju duhet ta dini se ata kanë asistuar në të gjitha mbledhjet që janë bërë për ligjin për shërbimet sociale. Ajo që unë dua ta bëjmë së bashku është që në vend që këto para të hidhen për financime të huaja apo ekspertiza të krijohen modele. Rasti konkret që kishte zonja është pikërisht krijimi i këtij modeli, ndërkohë që vetë politikat e agjencive të UN-it janë që më shumë të financohet në ekspertiza. Në fakt, ekspertiza është shumë e mirë dhe për këtë ju falënderoj, kjo nuk i takon vetëm Alketës, por UNICEF-it, si dhe të gjitha agjencive të UN-it në përgjithësi.

Ju ftoj t'i ngremë këto modele!

Pra, duke ngritur një model në një bashki. E para.

E dyta, do t'ju lutesha shumë, zoti kryetar, dhe e ngre me shumë forcë këtë, duhet të kërkonti seanca dëgjimore për buxhetin për çështjet sociale edhe me kryetarët e bashkive, sepse është e nevojshme që ata të deklarojnë këtu, se sa nga buxheti i tyre kanë dedikuar për çështjet sociale.

Për pjesën kur përfshihet mbrojtja e fëmijëve, kemi bërë një plan të fëmijëve në situatë rruge me shfrytëzim ekonomik. Qeveria ka në fokus dhe prioritet fuqizimin e familjes, ku është e nevojshme të punojnë së bashku në një sistem të ngushtë qeveria qendrore, vendore dhe organizatat e shoqërisë civile.

Nga ana tjetër, kemi një ngërç shumë të madh, sepse të gjithë donatorët përfshi këtu UNICEF-in, delegacionin europian dhe ambasadat e tjera financojnë organizata të shoqërisë

civile, por ne nuk kemi asnjë informacion se cila nga këto ka marrë financim të huaj. Këto bëhen në kuadrin e financimeve që bëjnë për qeverinë shqiptare. Kush i ka marrë dhe çfarë bëhet me to, ne nuk kemi asnjë lloj informacioni.

Ne kemi shoqatat që punojnë me ne, kemi një *network* ku i thërrasim për konsultime, sikurse dhe ju, por është njësoj, a bashkëpunoni ju me to? Jo, sepse ato marrin financim dhe bëjnë punën sipas termave që kanë në kontratën e financimit. Në fakt, ne nuk kemi asnjë lloj informacioni se cila nga këto shoqata ka marrë financim, sa kanë marrë dhe çfarë bën. Të paktën të mund të bashkëpunojmë për standardet. Kjo është situata.

Faleminderit!

Enver Roshi – Brikena do të na prezantojë një kërkesë që ka të bëjë me përfshirjen e depistimit të detyrueshëm të neonatëve për dëgjimin. Meqenëse UNICEF-i mbulon moshën e fëmijëve nga 0-15 vjeç, kjo përfshihet edhe në axhendën e tij për të futur si depistimin si të detyrueshëm në të gjithë vendin.

(Diskutim pa mikrofon)

Prandaj edhe ne sot kemi ftuar Brikenën, pedagoge në Fakultetin e Mjekësisë, njëkohësisht me profesion është otorino dhe koordinatore kombëtare e një projekti të ftuar nga Universiteti i Mjekësisë së Tiranës me komunitetin europian, me një financim prej 800 mijë eurosh që ka të bëjë me depistimin e të gjitha bebeve të lindura në Shqipëri.

Fjala për ju.

Brikena Qirjazi – Ju faleminderit!

Dëgjova shumë probleme të shoqatave që vijnë nga grupe të caktuara shoqërore, që kanë shkallë të ndryshme të paaftësive. Ajo që propozojmë është të parandalojmë handikapin dëgjimor, jo ta trajtojmë pas, por t'i dalim problemit para, që nesër, pasnesër të mos dëgjoni një përfaqësues të grupit të prindërve të fëmijëve që nuk dëgjojnë me ankesa, të cilat nuk e di se kur mund të adresohen.

E parë nga këndvështrimi i praktikës së përditshme, që ndodh realisht në Shqipëri, në kushtet shqiptare, kupton që fëmija nuk dëgjon rreth moshës 2 vjeç e gjysmë, 3 vjeç apo edhe më vonë. Sa më e rëndë të jetë ulja e dëgjimit, aq më shpejt e kupton. Pastaj këtu fillon kalvari i prindit që duhet të gjejë metodën e diagnostifikimit. Për moshat e vogla 3, 4 apo 5 vjeç diagnoza vendoset me anestezi gjeneralë, që është kosto e shtetit dhe e sistemit spitalor, ka rrisqet e anestezisë dhe më pas duhet të futet në procedurat e kempit, i cili është deri në 7 vjeç dhe pas saj e merr, se merr, apo si rifutet në kemp është një kalvar tjetër. Disa fëmijë që futen në shkollën e fëmijëve që nuk dëgjojnë, mësojnë gjuhën e shenjave dhe me të nuk shkojnë askund. Në shumë pak kanale televizive ka përkthyes të gjuhës së shenjave. Me një fjalë është

një barrë e madhe e sistemit shëndetësor, e sistemit arsimor dhe, në fund të fundit, e familjeve dhe shtetit shqiptar. Kjo është ajo që bëjmë ne.

Çfarë është ajo që bën bota? Europa në ditët e para të lindjes bën një test dëgjimi të fëmijës, por, në qoftë se nuk e kalon atë, kalon në procedura diagnostike dhe pastaj në varësi të shkallës së uljes së dëgjimit mund të ketë nevojë për logoped, për aparate dëgjimi apo për implante kokleare.

Metodat e rehabilitimit në Shqipëri janë, por ndoshta jo të strukturuar në mënyrën më perfekte. Ajo që na mungon është vlerësimi në moshën e neonatit, që nuk ka nevojë as për anestezi dhe as për kushte specifike për ta bërë.

Në tavolinat tuaja nuk është një hartëzim se ku ndodhet Shqipëria, por programi All screen i Komitetit European ka mbledhur të dhëna nga e gjithë Europa dhe ne jemi i vetmi vend që nuk kemi depistim të dëgjimit as tek i porsalinduri dhe as në moshën e futjes në shkollë. Në fakt, ky është një handicap i madh po të mendosh që testet e depistimit të dëgjimit në Shqipëri janë futur që në vitin 2004. Janë 15 vjet që ne punojmë. Kemi fonde e bëjmë, nuk kemi fonde, nuk e bëjmë.

Pse mendoj se është momenti për ta prezantuar në sistemin shëndetësor? Programi që përfaqësoj është një program i Universitetit të Mjekësisë dhe ka asistencë nga 5 universitete fantastike të Europës dhe këtu dalim tek ajo që me të drejtë thatë, që ne kemi ekspertizën e huaj dhe kemi krijuar një model që përshtatet për Shqipërinë.

Ne punojmë në 4 maternitete, deri tani shifra që keni i takon shtatorit, por lindje ka përditë, kemi mbi 18 mijë fëmijë të depistuar në dy maternitete të Tiranës, në Kukës dhe në Pogradec, pra është 1/3 e lindjeve shqiptare. Ajo që ne propozojmë është që si fillim në këto 4 institucione që punojmë, të vazhdojë depistimi shëndetësor.

Programi që unë përfaqësoj, që është një program i Universitetit të Mjekësisë, ka asistencë nga 5 universitete të Europës. Këtu dalim tek ajo që ju thatë se ne kemi ekspertizën e huaj dhe kemi krijuar model, nuk është thjesht pagesë ekspertësh, është një model që përshtatet për Shqipërinë. Ne punojmë në krah të maternitetit. Shifra që ju keni i takon shtatorit, por lindje ka ditë për ditë, kemi mbi 18 mijë fëmijë të depistuar, në dy maternitetet e Tiranës dhe në Kukës e Pogradec. Është një e treta e lindjeve shqiptare.

Ajo që ne propozojmë është që si fillim në këto 4 institucione që ne punojmë të vazhdojë depistimi, sepse kemi trajnuar 25 mami infermiere. Pra, personeli është gati. Kemi harxhuar mbi 200 mijë euro pajisje për depistime dhe për plotësimin e diagnostikës në spitalin “Nënë Tereza” në Tiranë. Është i vetmi kabinet i aftë të bëjë diagnozën e uljes e regjimit të moshës pediatrike në të gjithë Shqipërinë. Ndërkohë kemi bërë trajnime për logopedët dhe kemi

Qendrën e Zhvillimit të Fëmijëve në Kombinat që ka ekip multidisciplinor dhe që mund të trajtojë edhe fëmijët handikap. Me një fjalë ne kemi krijuar një model, i cili mund të funksionojë në kushte shqiptare. Ajo që duhet është që ky model të mos mbetet këtu dhe t'i rikthehemi pas një viti, kur aparatet janë vendosur në një qoshe dhe nuk bëjnë më, ku stafi duhet trajnuar nga fillimi, dhe ku ndërgjegjësimi i popullatës që ne kemi bërë me fletëpalosje me trajnime mjekësh, me fushata televizive në uebsite. Kemi në duar një material që përmbledh mendimin e prindërve të fëmijëve që depistohen aktualisht në maternitete. Po ta shikoni, një pjesë e mirë e fëmijëve janë gati edhe ta paguajnë vetë testin, në një kohë që paketa financiare që ne i propozojmë shtetit për të vazhduar depistimin në këto maternitete është më pak se 30 mijë euro, që do të mbulojë vetëm pagat e personelit, mirëmbajtjen e aparaturave ekzistuese dhe materialet e konsumit. Nëse këtij problemi do t'i rikthehemi pas 10 vjetësh, është 10-fishi i kostos që do të paguajmë tani. Ky është projekti më i madh i Bashkimit European që ka tërhequr tri universitete shqiptare. Nëse ne duam që Europa të hedhë fonde për Shqipërinë, ne duhet të jemi në gjendje t'i tregojmë Europës se ne këto fonde i përdorim për të krijuar modele ose struktura që i përdorim.

Enver Roshi – Atëherë, ju, Brikena, kërkon që projekti mbaron në fund të vitit të ardhshëm, por ky është një projekt pilot, që përfshin dy maternitetet e Tiranës, të Pogradecit dhe të Kukësit. Kjo është zgjedhur sipas nivelit të mirëqenies, sipas kushtit të Komunitetit European dhe kërkohet që pas vazhdimësisë në këto maternitete duhet të bëhet një plan strategjik për të bërë një projekt kombëtar, një depistim i detyrueshëm në të gjitha maternitetet e Shqipërisë.

Në komision është folur gjatë dhe unë pa dashur t'ju marr fjalën juve, sepse do të flisni të gjithë, Komisioni i Shëndetësisë e ka përkrahur, edhe Komisioni i Ekonomisë e ka mbështetur, besoj edhe Ministria e Shëndetësisë e ka dhënë mbështetjen, por kërkohet një plan strategjik kombëtar pas implementimit të këtij projekti pilot që është për vazhdueshmërinë. Pra, kërkon infermiere të dedikuara që të merren vetëm me depistimin e dëgjimit për neonatët. Ndërsa për rrethet e vogla, mamitë që punojnë aty mund të bëjnë depistimin.

Edlira Bode– Faleminderit!

Zonja Brikena, faleminderit që e sollët në vëmendjen e komisionit këtë problematikë.

Unë do të doja që për informacion të të pranishmëve dhe të kolegëve, në përvojën tuaj të di sa është incidenca e uljeve të dëgjimit që ju diagnostikoni dhe si është ndarë në nivele. Unë do të doja të kuptonim sa nga këta fëmijë do të përfitonin nga trajtimi, nëse diagnostikohen herët dhe sa nga këta janë subjekte të implementimit koklear.

Brikena Qirjazi- Faleminderit!

Unë desha t'ju kujtoj në parantezë që ulja e dëgjimit është patologjia më e shpeshtë e lindur. Ne kemi bërë studime paraprake, sepse janë bërë edhe projekte të mëparshme me incidencën e uljes së dëgjimit në Shqipëri, e kemi njëlloj si Europa, është 1 në 1 mijë lindje. Ndërsa grupi i riskut, ku futen shumë faktorë, që kryesisht janë fëmijët që përfundojnë në reanimacionet e bebes, është 10-fishi, pra 10 në 1 mijë lindje. Dhe ne grupin e riskut e kemi më të madh. Sigurisht, nuk mund të jap të dhëna për të gjithë Shqipërinë, por nga mostra jonë që është 1/3-ta e lindjeve vjetore, ne kemi rreth 20 fëmijë me ulje dëgjimi. Nga këto më shumë se 1/3 janë subjekte të implanteve kokleare. Problemi është që ne kemi një program implantesh kokleare, pavarësisht se nuk kemi implantuar asnjë deri tani me fondet e shtetit për efekte tenderësh dhe procedurash burokratike që sa vjen dhe plaket.

Sot në botë një fëmijë me ulje dëgjimi protezohet të implantohet, protezohet brenda 6-mujorit të parë të jetës, implantohet vetëm brenda vitit të parë të jetës. Ne në Shqipëri kemi 19-vjeçarë kandidatë për implant. Nëse ne i bashkojmë të gjitha paketat që ofron sistemi shëndetësor, është ideale që ne ta identifikojmë brenda vitit të parë në mënyrë që edhe implanti koklear, që është një kosto e madhe në sistemin tonë shëndetësor, të jetë efektive, sepse ndryshe grupet e pritjes që ne kemi vazhdojnë plaken dhe nuk kemi më kandidatë. Në Shqipëri ne kemi çdo vit rreth 60 fëmijë që nuk dëgjojnë, të cilët i shtohen listës. Jo të 60 janë kandidatë për implant, por 1/3 –ta e tyre janë, po t'i shtosh dhe meningjitin e sëmundjeve të tjera, grupi bëhet edhe më i madh. Ideja është që këtë fond kaq sa e kemi për sistemin ta bëjmë sa më efektive. E vetmja mënyrë për ta bërë efektiv është identifikimi, të bëhet brenda moshës kritike dhe në moshë të hershme. Unë kam parë fëmijë që janë protezuar brenda vitit të parë dhe flasin si të gjithë fëmijët e tjerë.

Edlira Bode- Pjesa tjetër, ajo 2/3-tat që nuk kanë nevojë për implantim, sa përfitojnë nga trajtimi që të rehabilitohen totalisht?

Brikena Qirjazi- Fëmijët, të cilët kanë ulje të lehta dëgjimi, kanë thjesht nevojë për asistencë në shkollë, kanë nevojë për trajtim logopedik. Sigurisht që ndiqen. Grupi që ka ulje dëgjime të mesme kanë nevojë për aparate dëgjimi. Te kriteret e reja të KEMPI-t, ku unë kam qenë pjesë e grupit të punës, janë shtuar në listën e pajisjeve asistuese edhe aparatet e dëgjimit. Si do të rregullohet kjo, për sa i përket pjesës financiare, unë nuk e di mirë, sepse vij nga komuniteti i pedagogëve, por realisht është parashikuar nga shteti që edhe aparatet e dëgjimit do të financohen nga shteti, kështu që në këtë sens përfitimi është 100%.

Adelina Rista- Faleminderit!

Unë është e disata herë që i kthehem dhe e lexoj projektin tuaj, ku keni theksuar atë që duan nënat, atë që do prindi. Cili është ai prind që nuk do që fëmijën e tij ta ketë perfekt dhe

jo më me mangësi në dëgjim. Ju keni cilësuar tri pikat kryesore, që nënat duhet ta dinë sa më herët që fëmija i tyre ka defekt, që nënat janë gati të paguajnë financimin sa i takon si kontributor së bashku me shtetin për të marrë vesh se ku shkon defekti që ka fëmija i tyre. Faktikisht unë kam ndjekur nga afër një problem të tillë në zonën time si deputete. Jam investuar shumë, por nuk arrita ta ndihmoja. Sot fëmija është 3 vjeç e gjysmë, prindërit janë zhytur në borxh deri në fyt që t'i bënin operacionin fëmijës për të vendosur implantit koklear. Për arsye sa vajza i ka të dy veshët që nuk dëgjon, kjo nuk u kap nga depistimi, por e kapën si prindër, që herët jam investuar se çfarë mund të bëhet për këtë fëmijë. Është në listën e pritjes, në krye, por në pamundësi, ashtu siç thatë edhe ju për burokracira tenderësh, ende ky implant nuk ka hyrë, Lista e pritjes shtohet, mosha ikën dhe disa përfitojnë disa jo. Tashmë kjo vajzë është operuar nga njëri vesh, pagoi 25 mijë euro dhe tashmë ky nuk përfiton nga lista e pritjes, sepse besoj do të zbresë në fund, sepse tashmë ky quhet invalid.

Më sqaroni për këtë, ju lutem! Pra ky fëmijë a përfiton që të bëjë operacion veshin e dytë?

Unë ju mbështes 100%. Kujdesi shëndetësor fillon nga parandalimi. Unë ju mbështes plotësisht për buxhetet që shkojnë për parandalimin. Ashtu siç është *check-up*-i, të jetë edhe ky depistim. E mbështes idenë tuaj si deputete, jam 100% mbështetëse e buxheteve që shkojnë për parandalimin.

Brikena Qirjazi - Unë mbase nuk mund të jap një përgjigje ekzakte, sepse prindi në fjalë do të jetë objekt i vendimit të një komisioni që unë jam vetëm një anëtare. Unë po ju sjell përvojën e Anglisë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më duhet t'i kthej zonjës një përgjigje. Ideja është që në vendet ku është futur paketa e implantit koklear është filluar me një implantim. Janë kosto shumë të mëdha, dhe vetëm në vende të mëdha bëhen të dyja. Një fëmijë me një vesh të implantuar në shumicën e rasteve është në rregull.

Enver Roshi – Anila Nepravishta përfaqësuese e Avokatit të Popullit.

Anila Nepravishta- Unë jam ndihmëskomisionere në seksionin e Mbrojtjes dhe Promovimit të të Drejtave të Fëmijëve tek Avokati i Popullit.

Besoj se problematikat që nxorën grupet e interesit janë problematika që edhe ne si institucion i mbrojtjes së të drejtave të njeriut i kemi parashtruar në raportet tona ose në rekomandimet që bëjmë. Shpesh nga administrata marrim përgjigjen që rekomandimi është i drejtë, por mungojnë buxhetet. Pra, gjithmonë buxhetet janë thembra e Akilit, pavarësisht

vullneteve të mira që kanë për t'u ndrequr parregullsitë që ne i kemi paraqitur në rekomandimet tona.

Ne keni parashtruar dy problematika në kontekstin e të drejtave të fëmijëve: në të drejtën për arsimim kemi konstatuar që nuk ka një nënndarje të veçantë të fondit për personel, mësues ndihmës tek arsimi parashkollor dhe parauniversitar, mbase nuk është për këtë komision, por po e them orientuar nga numri i fëmijëve me aftësi të kufizuar në njësitë e qeverisjes vendore dhe një tjetër është e lidhur me shpërndarjen e fondeve të pakushtëzuara të buxhetit të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore, i cili do të bazohej, siç thuhej në projekt, në numrin e fëmijëve të regjistruar në çerdhe e kopshte, në këto njësi dhe jo në numrin real të fëmijëve të grup-moshës 0-6 vjeç. Këto dy shqetësime kemi ngritur.

Enver Roshi- Po, Merita.

Merita Xhafaj - Që të arrihet të financohet një projekt kaq i madh në tri qytete dhe të mos bëhet dot një projekt i detajuar, unë me shumë dëshirë e pashë menjëherë sot në mëngjes, por këtu nuk ka asnjë kosto. Këtu është kostoja dhe raporti se çfarë është bërë nga projekti.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e ka. Ka vetëm shifra.

Ju lutem, kam marrë mendimin e 4 drejtorive në ministrinë time. Unë nuk jam nga ato që nuk thellohem në gjëra. Unë kam marrë mendimin e drejtorisë së Financës, të zëvendësministres Rakacolli që nga momenti që kemi hyrë dhe deri tani, se kemi 4 orë këtu. Ajo që kërkohet nga zonja me shumë predispozicion është që ky është një studim. E lexova, e pashë deri në detaj.

Ju lutem, a ka mundësi në kuadrin e të gjithë atij financimi të këtij projekti të bëhet një plan tranzicioni nga projekti të buxheti i shtetit? Ky ka disa elemente brenda, nuk ka vetëm kosto staf, sikurse përmendet këtu ose kosto materiale konsumi, ose mirëmbajtje. Kaq nuk e pranon Ministria e Financës edhe po të duam t'ia propozojmë.

A ka mundësi një plan tranzicioni? Financimi juaj ka qenë kaq, sot sa kërkoni të mbulohet, sepse, do një tranzicion. Hajdeni ta konsiderojmë vitin 2020 tranzicion, vendosni sa kosto do të paguani ju, sa ne, por jo në tri qytete, sepse, nëse e bëjmë pilotimin, e keni bërë ju, dhe nëse ka pasur rezultat, ju lutem vendosini dhe në fund të raportit të pilotimit bëjmë një konsultim të gjerë me gjithë Ministrinë e Financave dhe ta shikojmë dhe ta trajtojmë. Jam shumë dakord që ta bëjmë, por ju lutem ma dërgoni skeletin.

Lidhur me Avokatin e Popullit, jam shumë dakord, marrëdhëniet tona janë gjithmonë në vazhdim.

Enver Roshi- Merita, mbase ju nuk jeni në brendësi të kësaj pune, por letra nga Ministria e Shëndetësisë ka 3 muaj që ka ardhur. Ju nuk e keni thirrur asnjëherë zonjën.

Merita Xhafaj - Zonja ka pasur takime me zëvendësministren Rakacolli.

Enver Roshi – Më falni, nuk është thirrur asnjëherë ku t'i thuhet që bëhet kështu.

Klodiana Spahiu – Zonja Xhafaj, që ta bëjmë gjënë më të thjeshtë dhe më praktike dhe të shkojmë drejt zgjidhjes dhe jo të rrimë e të kërkojmë pse nuk është bërë deri sot.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të gjejmë zgjidhjen.

A jeni dakord ju të na lini një takim, doktoreshës edhe mua, në ministri dhe ta punojmë në grup, sepse asnjëra nga ne mund të mos jetë e aftë ta bëjë ashtu siç ju e kërkon.

Prandaj vijmë aty, na thoni kur dhe e hartojmë planin së bashku.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Enver Roshi– 200 mijë euro janë shpenzuar. Nëse ky projekt nuk mbështetet me këtë kosto prej 30 mijë eurosh ka gjasa që në fund të vitit të ardhshëm aparaturat të kenë dalë jashtë përdorimit, stafi të marrë drejtim tjetër dhe gjithë ky investim të hidhet në erë.

Ju lutem shumë, shkëmbeni emaile. Ne jua vëmë në dispozicion si komision parlamentar shumë prej 40 milionë lekësh që këta aparatura që janë të punojnë. Pra, ta shikojmë me idenë e së mirës, që ne të mos futemi në listën e zezë të komunitetit europian që një projekt kaq i madh vjen puna të mos vazhdojë. Është në dobi të 30 mijë fëmijëve që lindin në Shqipëri. Ky është një ndër projektet e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm.

Klodiana Spahiu – Ne dje e diskutuam me ministren dhe ramë dakord që të ketë një strategji kombëtare që do të jetë për të gjithë. Tani, a mund të bëhet një bashkëpunim për këtë strategji, pra një program kombëtar për depistimin e fëmijëve të porsalindur për dëgjimin?

Nëse Instituti i Shëndetit Publik, Ministria e Shëndetësisë së bashku me universitetin bëjnë një plan pune mendoj se ne shumë shpejt mund ta realizojmë këtë gjë që është bërë në tri qytetet edhe në qytet e tjera. Ky ishte edhe projekti i ministres që këtë gjë ta bënte si strategji kombëtare për të gjithë Shqipërinë.

Mesa po kuptoj, se nuk kam qenë që në fillim të bisedës, nga kërkesa që na ka ardhur kërkohet që këto që janë investuar deri tani të vazhdojnë si projekte dhe pastaj të bëhet një strategji kombëtare.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pa dashur për t'ju kundërshtuar, por nuk mund të realizohet një gjë e tillë, sepse, së pari, kjo është një kërkesë që ka impaktin e vet në buxhet, minimale, por e ka. Ju e patë që ka

gjëra të tjera shumë më të rëndësishme. Po të kishit qenë dje, do të dëgjoni kërkesa edhe më të vështira. Kështu që besoj se, nëse bashkëpunimi juaj me këto tri institucione do të jetë i mirë, strategjia nuk do shumë kohë. Profesori mund të na e shpjegojë më mirë, sepse ka punuar në institut, por besoj se në vitet 2020, 2021 mund të realizohet që të përfshihet në të gjithë Shqipërinë.

Brikena Qirjazi- Kërkesa ime sot ishte që, nëse e shkëputim punën e bërë, nuk e kapim dot më. Ne kërkojmë vazhdimësinë e kësaj që është bërë, e ndërkohë të përgatisim strategjinë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Për një vit është 30 mijë euro, që të mbahet ky sistem që është për tri qytete, por është 1/3 e lindjeve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në sensin e përdorimit të kujt buxheti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Enver Roshi- Nëse ne këtë ia lëmë dëshirës së një drejtori, nuk do të vlerësohet. Ne duhet ta bëjmë këtë që të futet një arritje e qeverisë shqiptare që depistimi të bëhet i detyrueshëm, por po t'ia lëmë dëshirës së personave nuk bëhet. Ne duam që kjo shumë ky buxhet që është minimal te këto drejtorë të tregohet se kjo shumë është për këtë gjë, prandaj mos e devijoj.

Ju falënderoj për mirëseardhjen.

Ju uroj suksese!

Ky komision është i hapur dhe ju mirëpret të gjithë kohën!